



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
GRUPI PARLAMENTAR DEMOKRAT

KALLËZIM PENAL

KALLËZUESI: Grupi Parlamentar “DEMOKRAT” i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

OBJEKTI: Kallëzim i Veprave Penale të mëposhtme:

- “Korrupsion Aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 244;
- “Korrupsion Aktiv i funksionarëve të lartë shtetëror ose të zgjedhurve vendorë” parashikuar nga neni 245;
- “Shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga neni 248;
- “Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike” parashikuar nga neni 258;
- “Korrupsion Pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259;
- “Korrupsion Pasiv i funksionarëve të lartë shtetëror ose të zgjedhurve vendorë” parashikuar nga neni 260;

KUNDËR:

1. Sandër LLESHAJ, Ministër i Brendshëm;
2. Drejtoria e Blerjeve të përqëndruara (ABP)
Znj. Edlira NAQELLARI;
3. Anëtarët e Komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO),
si dhe cdo anëtar tjetër pjesëmarrës në procedurën e mëposhtme;
4. Olta XHAÇKA, Ministre e Mbrojtjes;
5. Agjensia e Prokurimeve Publike;

6. D&E sh.p.k. me NUIS K71804001C me adresë, Tiranë Njësia Bashkiake nr. 5, rruga “Mito Tutulani” pallati “Alb Millenium” nr. 6, kati 2.

7. MARSI&AL sh.p.k. me NUIS L21502014K me adresë, Tiranë rruga “Sami Frashëri” pallati “Aviacioni i Vjetër”,shk. 2, ap. 4.

BAZA LIGJORE: Nenet 75/a, 280, 283 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, neni 244, 245, 248, 258, 259, 260 i Kodit Penal, nenet 8, 9, 10 e vijues të Ligjit nr. 95/2016 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar me Ligjin nr. 9800, datë 10.09.2007, Ligjin nr. 9855, datë 26.12.2007, Ligjin nr. 10170, datë 22.10.2009, Ligjin nr. 10309, datë 22.07.2010, Ligjin nr. 22/2012, Ligjin nr. 131/2012, Ligjin nr. 182/2014 dhe Ligjin nr. 47/2017, Ligjin 103/2018 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

DREJTUAR: Prokurorisë së Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit-SPAK.

Të Nderuar,

Më poshtë po Ju parashtrojmë këtë kallëzim penal për “Shpërdorim Detyre” etj, sic janë edhe të sipërcituara në objektin e kallëzimit, duke sqaruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet konsumimi i veprës penale;

1. MINISTRIA E BRENDSHME

Më datë 11.05.2020, u zhvillua procedura e tenderit me objekt “Blerje dhe shpërndarja e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit” për 4 vjet me fond limit: 2,800,347,570 lekë të reja pa TVSH apo 27 milion euro me TVSH. **Fituesi i paracaktuar, ishte firma “D&E” sh.p.k.** e cila nuk plotësonte shumë kushte e dokumenta të kërkuara dhe ndonëse ofronte rreth 5 miliard lekë më tepë se operatori i klasifikuar si i pari. **Sandër Lleshaj ishte i vendosur që në kundërshtim me ligjin ta shpallte fitues.** Skandali merr përmasa edhe më mëdha. Kjo për vetë faktin se tenderi është mbajtur në datë 11.05.2020 dhe sipas ligjit, klasifikimi duhet të ishte bërë brenda 10 ditësh, por **ndërkohë fituesi është publikuar online më datë 14.07.2020.**

Në fillim të procedurës në Komisionin e vlerësimit të Ofertave ishin 3 anëtarë të cilëve u bë presion që të s’kualifikohej kompania e parë e renditue e para e cila plotësonte të gjitha kriteret, ka ofruar edhe 5 miliard lekë më pak. Si pasojë e rezistencës së një pjese të këtij komisioni për të shkelur ligjin, në këtë komision u shtuan papritur dy anëtarë të rinj pa asnjë shpjegim, duke e çuar numrin në pesë persona. **Nga ana e Drejtoreshës së Agjencisë së Blerjeve të Përqendruar Edlira Naqellari, nën bekimin e Sandër Lleshajt,** këtyre personave të komisionit u janë ofruar para për të s’kualifikuar firmën e kualifikuar si e para, por pasi një pjesë e tyre kanë vendosur që të mos e shkelin ligjin, **Edlira bashkë me Sandër Lleshajn kanë vendosur të shkrijnë Komisionin.** Krejt papritur një nga anëtarët e komisionit dha dorëheqjen më datë 9.06.2020 në mes të procedurës pa asnjë shpjegim.

Edlira Naqellari dhe Sandër Lleshaj kanë ushtruar një presion të jashtëzakonshëm ndaj pjestarëve të komisionit që të s'kualifikohej kompania e parë **dhe të fitonte kompania e përzgjedhur nga Sandër Lleshaj, "D&E" sh.p.k.** Por në fakt provat dhe të dhënat janë kokëfortë pasi firma e klasifikuar e para, e quajtur Genç Taahhüt Giyim Tekstil İnşaat San. Ve Tic. Ltd. Sti., i plotësonte të gjitha kriteret dhe kushtet e tenderit dhe për më tepër ka ofruar 5 miliard lekë më pak se firma që do të shpallë Sandër Lleshaj si fituese.

Kompania "D&E" sh.p.k., nuk plotësonte një sërë kushtesh teknike, dhe ka mungesë dokumentacioni të theksuara falsifikuar dhe dokumentacionin e paraqitur. Mjafton kaq, që kjo kompani jo vetë të mos fitonte tenderin, por edhe të ndiqet penalisht. Gjithçka që po përmendim është lehtësisht e verifikueshme dhe e shkruar e zeza në të bardhë.

Drejtoresha e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruar Edlira Naqellari, nën derigjimin e "mjeshtrit të lekut" Sandër Lleshaj, ia arritën të gjejnë kamikazin e tretë të komisionit që me votën e tij do u sigurojë atyre "fitoren" e kompanisë "D&E" sh.p.k. plot 5 miliard lekë që do të futen në xhepin e qeverisë Rama. Tashmë që komisioni përbëhej nga 5 anëtarë, kompania "D&E" sh.p.k do ti duheshin minimalisht 3 vota për të arritur "fitoren".

Treshja e famshme, që do të siguronte përfundimin e këtij plani me sukses përbëhet nga:

1. **Kreshnik Bejkaj** (Anëtar i KVO) që në fillim të procedurës, i paguar në mënyrë korruptive për t'i mbyllur të dy sytë dhe për të firmosur për kompaninë që ka urdhëruar shefi Sandër Lleshaj.
2. **Mariglen Bazali** ("kamikaz") i shtuar në mënyrë të paligjshme në mes të procedurës për të çuar në vend planin e Ministrit Lleshi, ky person nuk është pjesë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, por një person i rëndomtë, pa asnjë titull apo kopetencë për të marrë vendim mbi një çështje kaq serioze, por i aftë për t'i shkaktuar shqiptarëve një dëm kaq të madh ekonomik prej 5 miliardë lekë vetëm sepse ka marrë rryshfet për të firmosur për kompaninë "D&E" sh.p.k.
3. **Fatmir Derhemi** ("kamikaz") i fundit i cili u shtua në mes të procedurës pasi një prej komisionerëve u kanos me jetë dhe u detyrua me forcë të jap dorëheqjen, pasi konstatoi se kompania "D&E" sh.p.k. duhej të s'kualifikohej menjëherë, madje të ndiqej penalisht. Ky personazh nuk është asgjë tjetër përveçse një i korruptuar, i cili për disa euro është i gatshëm të dëmtojë të gjithë Shqiptarët dhe të firmosë në mënyrë të padrejtë. Për më tepër që nuk ka një tagër për të qenë anëtarë në Komisionin e Vlerësimit të Ofertave, por është një individ që vjen nga rruga për të firmosur sipas urdhërit të Edlira Naqellari e cila me orientimin e Sandër Lleshajt duhet të shpallë fituese me çdo kusht kompaninë "D&E" sh.p.k.

Fituesi i tenderit që ashtu siç parashikohej, u shpall **Bashkimin e Operatorëve Ekonomik: "D&E SH.P.K." + "SUMMER CONF. s.r.l." + "LOVERS s.r.l." + "YAKUPOGLU TEKSTIL VE DERI SAN. TIC. AS A. VEDAT YAKUPOGLU". M.Gjini JOQ Albania.**

SKANDALI ME TENDERIN TË UNIFORMAVE TË POLICISË TË SHTETIT

Ministria e Brendshme ishte e parapërgatitur dhe e vendosur për të grabitur hapur vlerën e 500,000,000 lekë. Nga Tenderi i hapur "Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit", në fondin limit: 2.800.347.570 lekë pa TVSH (3,360,417,084 lekë TVSH), **zhvilluar më datë 11.05.2020**

Dyshohet se nëpërmjet përdorimit të skemës "mafioze", shumatorja e çmimeve për njësi, grabitja nga uniformat dhe këpucët, etj të Policisë së Shtetit, mund të shkojë dhe në 1,157,815,852 lekë "Vjedhje në rrethana cilësues"

TENDER! Data e hapjes: 26-07-2019 Data e mbylljes: 11-05-2020. Plot një vit, ndërsa ofertat ekonomike janë hapur në datë 11-05-2020. Pas "pazareve" "formaliteteve", skemave "mafioze" e "manovrave" që u kryen, **Ministria e Brendshme, më datë 14.07.2020, më në fund, ka shpallur fituesin e këtij tenderi, kompaninë shqiptare me aktivitet Gërmime Dheu, "D&E" SHPK, që ofroi 500,000,000 lekë më shumë nga vlera që ofroi kompania Turke Genç Taahhüt Giyim Tekstil İnşaat San. Ve Tic. Ltd. Sti. Vjedhja e vlerës prej 500,000,000 lekë ishte e parashikuara (planifikuar) që në DT (Dokumentat e Tenderit)**

Pra ky tender u publikua më datë 26.07.2019, (nga 3 kandidatët e përzgjedhur në fazën e parë), Faza I - Parakualifikimi, ofertat ekonomike dhe mostrat e uniformave etj, nga 3 kandidatët e përzgjedhur në fazën e parë, u dorëzuan më datë 11.05.2020 për Faza 2 – Ftesa për Ofertë:

Më datë 26.07.2019, Ora: 09:58, publikohet nga Autoriteti kontraktues: Agjencia e Blerjeve te Perqendruara

në Ministrinë e Brendshme, Dokumentet e Tenderit, Objekti i tenderit: “Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit, Proçedura : E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar Fondi limit : 2,800,347,570.00 Lekë pa TVSH.

Procedura : E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar Fondi limit : 2,800,347,570 Lekë pa TVSH: Objekti i marrëveshjes kuadër:“Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit”, për 4 vjet (2019-2022), publikohet në gjuhën Shqip dhe Anglisht, Buletini Nr.30 datë 29 Korrik 2019 të Agjencisë së Prokurimit Publik, faqet 12/492 dhe 13/493, publikon: Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, në Ministrinë e Brendshme, më datë 19.08.2019, hap “Procedurën e Kufizuar nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër, **me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të pëcaktuara, me afat marrëveshje kuadër 4 (katër) vite.** **Objekti i marrëveshjes kuadër: “Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit”. Fondi limit: 2,800,347,570 lekë pa TVSH.**

Duke përcaktuar se afati kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje do të jetë data 19/08/2019 Ora:10:00, në: www.app.gov.al në Agjencinë e Blerjeve të Përqendruara, Ministria e Brendshme, Sheshi “Skënderbej”, nr.3, Tiranë.

Por çndodh! U trumbetua me të madhe sikur specifikimet teknike të DT (Dokumentat e Tenderit), që do të përdoshin për prodhimin e artikujve të uniformës së Policisë së Shtetit, për procedurën e tenderit parashikuar për tu hapur më datë 19.08.2019, ishin diktuar dhe shkonin në favor të një kompanie shqiptare prodhim veshje, për të fituar tenderin e uniformave të Policisë së Shtetit, në vlerën prej 28.800.347.570 lekë pa TVSH.

Sa më sipër duke i marrë të mirëqena diktimin e specifikimeve teknike nga kompania shqiptare prodhim veshje, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, në Ministrinë e Brendshme, pezullon procedurën e tenderit që ishte parashikuar për tu hapur më datë 19.08.2019.

Sepse kompani Kroate kishin shfaqur interes për të marrë pjesë në Tenderin me Objekt: “Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit, në fondin limit 2,800,347,570.00 Lekë pa TVSH.

Kompanitë Kroate duke mos qenë dakort me specifikimet teknike të DT (Dokumentat e Tenderit) të kësaj procedure, nëpërmjet përfaqësuesit të tyre në Shqipëri, firmës “Ro.gat security” bëjnë ankesë me propozime konkrete pranë Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, në Ministrinë e Brendshme, për ndryshimet e specifikimeve teknike e modifikime të ndryshme në DT (Dokumentat e Tenderit) të procedurës së datës 19.08.2019.

Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, në Ministrinë e Brendshme, merr në konsideratë propozimet e kërkuara nga kompanitë Kroate, ndryshimet e specifikimeve teknike e modifikime të ndryshme në DT (Dokumentat e Tenderit) të procedurës së datës 19.08.2019. Procedura e datës 19.08.2019 pezullohet, ndryshimet e specifikimeve teknike e modifikime të ndryshme në DT (Dokumentat e Tenderit) të procedurës së datës 19.08.2019, bëhen fakt i kryer.

Faktin e ndryshimeve të specifikimeve teknike dhe modifikimeve të ndryshme në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit, të datës 19.08.2019, e ka publikuar zyrtarisht Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, në Ministrinë e Brendshme, **datë 15.10.2019, nëpërmjet SHTOJCË NR.1** “Për disa ndryshime / modifikime në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit, “Procedurë e Kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar” me objekt:“Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit”, afati kohor për dorëzimin dhe hapjen e kërkesave për pjesëmarrje (Faza I - Parakualifikimi), Data: 05/11/2019(dd/mm/vvvv) Ora:10:00,duke përdorur termat **ISHTE** (Për procedurën e datës 19.08.2019) – **BËHET** (Për procedurën e rihapur datë 5.11.2019)

Pas pezullimit të procedurës së datës 19.08.2019, procedura e tenderit të uniformave të Policisë së Shtetit, rihapet më datë 5.11.2019.

Por tashmë, ndryshimet e specifikimeve teknike e modifikime të ndryshme në DT (Dokumentat e Tenderit) të kompleksuara e të ndërlikuara qellimisht, por që janë të diktuar e të falsifikuara **në procedurën e tenderit të rihapur më datë 5.11.2019, shkojnë në favor të kompanive Kroate, në bashkëpunim me firmën shqiptare “Ro.gat security” me eksperiencë pothuajse zero në fushën e prodhimit dhe trajtimit të veshmbathjeve.**

Për këtë procedurë “mafioze” të këtij tenderi, nga Ministria e Brendshme është përzgjedhur dhe emri i firmës shqiptare “Ro.gat security”, që i është bërë ftesë që të paraqesë ofertë ekonomike në përllogaritjen e çmimit për artikujt e uniformës së Policisë së Shtetit, për llogari të firmave Kroate..

Çmimet nga përllogaritjet të paraqitura nga firma shqiptare “Ro.gat security” që vepron në emër të kompanive Kroate, por edhe shoqërive të tjera të përzgjedhura nga Ministria e Brendshme, ofertat ekonomike në përllogaritjen e çmimit për çdo artikuj të uniformës së policisë të paraqitura prej tyre, **kanë dhënë çmime fiktive dhe shumë herë më të larta, të dyshimta në krahasim me testimet e mëparshme???**

Sipas DT (Dokumentave të Tenderit)! Ja skemat “Mafioze” të përdorur nga Ministria e Brendshme, që dyshohet se kanë cuar në grabitjen e 500.000.000 lekë nga Tenderi i uniformave të Policisë së Shtetit, sipas tabelave të mëposhtme të cilat janë me shkurtime (të plota gjenden në Dokumentat e Tenderit).

SKEMË “MAFIOZE” NR.1

Precedenti i parë është: nëpërmjet uljeve të sasive të Uniformave, Aksesorë, Grada, Stema, Shenjat e Policisë së Shtetit, por jo të fondit limit që mbetet i pandryshuar: **2,800,347,570 Lekë pa TVSH?**, dhe **Nr.Rendor mbetet i pandryshuar nga 1 deri 123**, si më poshtë:

Tek Shtojca 13 “SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT”, sasia e pritshme e artikujve të uniformës që kërkohen:

ISHTE: (Procedura datë 19.08.2019), **pezulluar.**

Kishte të pasqyruar një tabelë që përbëhet nga 8 kolona, me këto të dhëna: **1.** Nr.Rendor nga 1 deri 123, **2.** Artikujt e Uniformës, **3.** Njësia Matëse, **4.** Viti I Sasia 75,378, **5.** Viti II Sasia 183,353, **6.** Viti III Sasia 268,965, **7.** Viti IV Sasia 198,947, **8.** Total Sasia **726,643**, me **Fondin limit: 2,800,347,570 Lekë pa TVSH**, si më poshtë:

ISHTE, Sipas DT (Dokumentave të Tenderit), Formati i tabelës në procedurën datë 19.08.2019, pezulluar, me këto të dhëna:

Shtojca 13

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e pritshme e artikujve të uniformës që kërkohen:

Nr.Rendor.	Artikujt e Uniformës: nga Xhup shërbimi (3/4)(me veshje të ngrohtë), deri Këpuçë taktike verore për strukturat e veçanta	Njësia Matëse	Viti I	Viti II	Viti III	Viti IV	TOTAL
			Sasia	Sasia	Sasia	Sasia	Sasia
nga 1 deri 123	2	3	4	5	6	7	8
	Total Sasia e artikujve të Uniformës	Copë/kompl/palë	75,378	183,353	268,965	198,947	726,643

BËHET Sipas DT (Dokumentave të Tenderit), Formati i tabelës në procedurën e rihapur datë 5.11.2019 datë 19.08.2019, pezulluar, me këto të dhëna:

Ka të pasqyruar një tabelë, që përbëhet nga 4 kolona, me këto të dhëna: **1.** Nr.Rendor nga 1 deri 123, **2.** Artikujt e Uniformës, **3.** Njësia Matëse, **4.** Sasia e pritshme (në total) Total Sasia **bëhet 486,658**, po me **Fondin limit: 2,800,347,570 Lekë pa TVSH?**, si më poshtë:

BËHET, Sipas DT (Dokumentave të Tenderit), Formati i tabelës në procedurën e rihapur datë 05.11.2019, **kamuflohet** me këto të dhëna:

Shtojca 13

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e pritshme e artikujve të uniformës që kërkohen:

Nr.Rendor.	Artikujt e Uniformës: nga Nr. 1- Xhup shërbimi (3/4)(me veshje të ngrohtë), deri Nr.123- Këpucë taktike verore për strukturat e veçanta	Njësia e Matjes	Sasia e pritshme (në total)
nga 1 deri123	2	3	4
Total Sasia e artikujve të Uniformës		Copë/kompl/palë	486,658

Nga krahasimi i procedurës së rihapur të datës 5.11.2019, me procedurën e datës 19.08.2019 të pezulluar, rezulton të blihen më pak në Total Sasia prej 239,985 artikuj. (ISHTE Total Sasia prej 726,643 artikuj - BËHET - Sasia e pritshme (në total) prej 486,658. (726,643 - 486,658 = 239,985 Total Sasia, do të blihen më pak).

Interesant fakti! Si me Total Sasia prej 726,643 artikuj në procedurën e datës 19.08.2019 të pezulluar, ashtu në Total Sasia prej 486,658 artikuj, në procedurën e rihapur më datës 5.11.2019 (239,985 Total Sasia, do të blihen më pak), Fondi limit: 2,800,347,570 Lekë pa TVSH, mbetet i pa ndryshuar? dhe Nr.Rendor mbetet i pa ndryshuar po nga 1 deri123?

Objekti i marrëveshjes kuadër: “Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit”, në DT (Dokumentat e Tenderit) sipas procedurës më datë 19.08.2019, ISHTE për 4 vjet (2019-2022) dhe e detajuar sipas viteve (Viti I Sasia, Viti II Sasia, Viti III Sasia, Viti IV Sasia), ndërsa:

Objekti i marrëveshjes kuadër : “Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit”, në DT (Dokumentat e Tenderit), të ndryshuar, sipas procedurës e rihapur më datë 5.11.2019, BËHET për 4 vjet???, por jo e detajuar siç ishte në procedurën datës 19.08.2019, pezulluar, sipas viteve (Viti I Sasia?, Viti II Sasia?, Viti III Sasia?, Viti IV Sasia)? **Atëhere sa do të jetë sasia totale e artikujve të uniformave, që do të prodhohen për çdo vit???**

Formati i tabelës së procedurës më datë 19.08.2019 të pezulluar, **përbëhej nga 8 kolona**, ndërsa formati i tabelës së procedurës së rihapur më datë 5.11.2019 **përbëhet nga 4 kolona???**

Çka do të thotë se , formatit i tabelës së procedurës së rihapur më datë 5.11.2019, ndryshe nga formati i tabelës së procedurës më datë 19.08.2019 të pezulluar, **është i kamufluar** në përmbajtje, i mungojnë 4 kolonat për 4-vite (Viti I Sasia?, Viti II Sasia?, Viti III Sasia?, Viti IV Sasia)?

Pikërisht nga formati i kamufluar të tabelës së procedurës së rihapur më datë 5.11.2019, të pa detajuar në 4 – tër kolonat për 4-vite (Viti I Sasia?, Viti II Sasia?, Viti III Sasia?, Viti IV Sasia?), **zbulohet dukshëm ulja totale e sasive prej 486,558, ndërsa fondi limit 2.800.347.570 pa TVSH, mbetet i pandyshuar?**

Ndërsa Nr.Rendor mbetet po nga 1 deri123, por që në total sasia e tyre për procedurën e rihapur më datë 5.11.2019, është më e ulët për 80 artikuj , krahasuar me sasinë që përmban tabela (sasia dhe grafiku i lëvrimit), të tenderit parashkuar për tu hapur më datë 19.08.2019, të pezulluar, si më poshtë:

ISHTE – Sasi të totale sipas Dokumentave të Tenderit – Procedura datë 19.08.2019, pezulluar, Total **489,911** artikuj, për 80 artikuj.

BËHET – Sasi të totale sipas Dokumentave të Tenderit të ndryshuara - Procedura rihapur datë 5.11.2019, Total **249,926** artikuj, për 80 artikuj?

SASITË - që do të blihen më pak në procedurën rihapur datë 5.11.2019, në Total Sasia është prej 239,985 për 80 artikuj, ka kamufluar Fondin limit: 2,800,347,570 lekë pa TVSH. **Total Sasia prej 239,985 që mendohet të vlerësohet me 500.000.000 lekë, është vjedhja** sipas kësaj skeme “mafoze” të fshehtë të përdoruar nga zyrtarët e lartë të Ministrisë së Brendshme, të parashikuara (planifikuar) që në DT (Dokumentat e Tenderit), të realizuar përmes shpërdorimit të detyrës dhe korrupsionit, paraqitur në tabelën e mëposhtme:

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e pritshme e artikujve të uniformës që kërkohen:

Nr.Rendor.	Artikujt e Uniformës	Njësia Matëse	ISHTE – Sasi të totale sipas Dokumentave të Tenderit – Procedura e pezulluar Datë 19.08.2019	BËHET – Sasi të totale sipas Dokumentave të Tenderit të ndryshuara - Procedura rihapur Datë 5.11.2019	SASITË - totale më pak që do të blihen në Procedurën rihapur Datë 5.11.2019
nga 1 deri 123(I)	Uniforma, Aksesorë, Grada, Stema, Shenjat e Policisë së Shtetit (II)	(III)	(IV)	(V)	VI(IV-V)
Gjithsej	80(tetëdhjetë) artikuj	Totali	489,911	249,926	239,985

SKEMË “MAFIOZE” NR.2

Precedenti i dytë është: nëpërmjet shpikjes “mafioze”: shumatores së çmimeve për njësi, që është përdorur në DT (Dokumentat e Tenderit) dhe që shkojnë në favor të Operatorëve Ekonomik afër zyrtarëve të lartë të Ministrisë Brendshme, pjesmarrës në tenderin “Blerje dhe shpërndarje uniforma e këpucë” për Policinë Shtetit”.

Shumatorja e çmimeve për njësi, një “mekanizëm” që Operatori Ekonomik “D&E” SHPK, fituese e tenderit, dyshohet se ka përdorur, me çmimet për njësi, fondit/vlerës së kontratës prej 2,800,347,570 lekë pa TVSH, që është rihapur procedura e tenderimit datë 5.11.2019, për të ruajtur të paprekshme grabitjen e vlerës prej 500,000,000 lekë, parashikuar për vjedhje, që në DT (dokumentat e tenderit), që shkojnë në favor të zyrtarëve të lartë të Ministrisë së Brendshme.

Shumatorja e çmimeve për njësi, skemë “Mafioze” - Vjedhje. Sepse Vlerësimi i Ofertës Ekonomike që dyshohet që të jetë bërë duke u bazuar vetëm në shumatoren e çmimeve për njësi, dhe pikët maksimale i janë ofertuesit i cili paraqet shumatoren e çmimeve për njësi më të ulët, **KA KUMUFLUAR Fondin limit: 2,800,347,570 lekë pa TVSH,** që është rihapur procedura e tenderimit, Objekti i marrëveshjes kuadër: “Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit”.

Skemën e shpikjes “mafioze” : të Vlerësimi i Ofertës Ekonomike që dyshohet që të jetë bërë duke u bazuar vetëm në shumatoren e çmimeve për njësi, dhe pikët maksimale i janë ofertuesit i cili paraqet shumatoren e çmimeve për njësi më të ulët, “Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit” **e zbulon, Tenderi i Uniformave të Gardës së Republikës, i datës 08.07.2020.**

Si Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ashtu dhe Garda e Republikës, janë dy institucione në varësi të Ministrisë së Brendshme.

Por Agjencia e Blerjeve të Përqendruara (ABP) në Ministrinë e Brendshme, me veprime dhe në mos përputhje për të njëjtën Lloji i procedurës së prokurimit (Objekti i marrëveshjes kuadër), **aplikon vlerësimin e Ofertave ekonomike me dy standarde:** ndryshe e të dyshimtë për tenderin e uniformave të Policisë së Shtetit dhe ndryshe konsideruar të rregullt për tenderin e uniformave të Gardës së Republikës.

Ndërsa Agjencia e Prokurimit Publik bëhet palë, që veprimet në mos përputhje për të njëjtën Lloji i procedurës së prokurimit (Objekti i marrëveshjes kuadër), të **Agjencia e Blerjeve të Përqendruara,** publikon dy qendrimet e (ABP) për vlerësimin e Ofertave Ekonomike.

Në datë 08.07.2020, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara ka hapur“ Procedurë e hapur”, nëpërmjet marrëveshjes kuadër, **me një operatorë ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara**, me afat të marrëveshjeve kuadër 12 (dymbëdhjetë) muaj. **Objekti i marrëveshjes kuadër: “Blerje uniformash dhe elementesh të tjera përbërëse të tyre për Gardën e Republikës”, Fondi limit: 9,933,334 Lekë** pa TVSH.

Duke përcaktuar se afati kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje do të jetë data 08.07.2020 (dd/mm/vvvv) Ora: **12:00**, Vendi: Agjencia e Blerjeve të Përqendruara ne Ministrinë e Brendshme, Tiranë.

”Procedurë e hapur”, nëpërmjet marrëveshjes kuadër, **me një operatorë ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara**, me afat të marrëveshjeve kuadër 12 (dymbëdhjetë) muaj, është botuar Buletini Nr.37 datë 22 Qershor 2020 të Agjencisë së Prokurimit Publik, faqet 19/369 dhe 20/369.

Në DT (Dokumentat e Tenderit) për uniformat e Policisë së Shtetit, tregohet se:

Në rastin kur objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, shumatorja e çmimeve për njësi : ISHTE: në procedurën datë 19.08.2019, pezulluar, **488,141 Lekë** (pa TVSH), **BËHET** në procedurën e rihapur, datë 5.11.2019 **621.011 Lekë** (pa TVSH).

Vlerësimi i Ofertës Ekonomike do të bëhet duke u bazuar vetëm në shumatoren e çmimeve për njësi. Pikët maksimale do t’i jepen ofertuesit i cili paraqet shumatoren e çmimeve për njësi më të ulët. Në cdo rast, operatorët ekonomik duke iu referuar sasive të pritshme përkatëse, nuk duhet të tejkalojnë as shumatoren limit të artikujve të uniformës dhe as vlerën e pritshme të kontratës (fondin limit të marrëveshjes kuadër).

Por si Operatorët ekonomik duhet ta tejkalojnë vlerën e pritshme të kontratës (fondin limit të marrëveshjes kuadër) 2,800,347,570 lekë, **kur Vlerësimi i Ofertës Ekonomike do të bëhet duke u bazuar vetëm në shumatoren e çmimeve për njësi dhe jo sipas çmimit total të ofertës 2,800,347,570 lekë, referuar sasisive të pritshme???**

Në DT (Dokumentat e Tenderit) për uniformat e Gardës së Republikës, tregohet se:

Në rastin kur objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, shumatorja e çmimeve për njësi është: **nuk aplikohet???**

Klasifikimi përfundimtar i operatorëve ekonomikë të suksesshëm në marrëveshjen kuadër do të bëhet sipas çmimit total të ofertës referuar sasive të pritshme të përcaktuara në shtojcën 12 të DT –së (Sasia dhe grafiku i lëvrimit).

Pra, për të njëjtën Lloji i procedurës se prokurimit (marrëveshjes kuadër), për uniformat e Policisë së Shtetit, në rastin kur objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi: APLIKOHET**, ndërsa për uniformat e Gardës së Republikës, **shumatorja e çmimeve për njësi: NUK APLIKOHET ???**

Në DT (Dokumentat e Tenderit) për uniformat e Policisë së Shtetit, përcaktohet se, Vlerësimi i Ofertës Ekonomike do të bëhet duke u bazuar vetëm në shumatoren e çmimeve për njësi, për sasinë 1 (një) copë/komplet/palë, dhe jo sipas çmimit total të ofertës referuar sasive të pritshme të përcaktuara në shtojcën 13 të DT –së (Sasia dhe grafiku i lëvrimit)???, ndërsa:

Në DT (Dokumentat e Tenderit) për uniformat e Gardës së Republikës, përcaktohet se, Klasifikimi përfundimtar i operatorëve ekonomikë do të bëhet sipas çmimit total të ofertës referuar sasive të pritshme të përcaktuara në shtojcën 12 të DT –së (Sasia dhe grafiku i lëvrimit)???

Në DT (Dokumentat e Tenderit) për uniformat e Policisë së Shtetit, në shtojcën 3 [Shtojcë për t’u plotësuar nga operatori ekonomik], në FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE, është përcaktuar: **Shumatorja limit e çmimeve për njësi, në total (Lekë pa TVSH), 621,011, ndërsa:**

Në DT (Dokumentat e Tenderit) për uniformat e Gardës së Republikës në shtojcën 1[Shtojcë për t’u plotësuar nga operatori ekonomik], në FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE, është përcaktuar: **Fondi limit i marrëveshjes kuadër, në (LEK) pa TVSH 933,334???**

Ja konkretisht se si u zbatua shpikja “mafioze” e shumatores së çmimeve për njësi?

Në DT (Dokumentat e Tenderit) për uniformat e Gardës së Republikës, tregohet:

Shtojca 1

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit _____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-së

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasitë e pritshme	Cmimi për njësi pa TVSH	Çmimi total (pa TVSH)
A/1	Uniforme Oficeri e Nënoficeri Gardë				
1	Kostume uniforme (oficeri e nënoficeri)	komplet	50		
2	Kostume shërbimi e stërvitje	komplet	490		
3	Xhup 3/4 me veshje te ngrohtë	copë	200		
4	Xhup i shkurtër	copë	50		
5	Kemishë me mëngë të shkurta	copë	200		
6	Bluza mëngë të shkurta me tre kopsa	copë	600		
7	Bluza pambuku mëngë të shkurta	copë	200		
8	Bluza pambuku mëngë të gjata	copë	400		
9	Këmishë me mëngë të gjata	copë	100		
10	Pelerinë shiu	copë	100		
11	Rrip multifunksional (pa aksesore)	copë	200		
12	Rrip pantalloni	copë	80		
13	Kravate uniforme	copë	80		
A/2	Uniformë për kontrollorët-shoqërues (policia rrugore)				

1	Kostum dimeror (xhup pantallona, kapele sport)	komplet	20		
2	Pantallona doku ripstop + kapele	palë	20		
3	Bluze pambuku me 3 kopsa, menqe te shkurtra pol. rrug.	copë	40		
A/3	Uniforme Truproje Nderi				
1	Kostum ceremoniali vere	komplet	26		
2	Doreza te bardha ceremoniali	palë	100		
Fondi limit i marrëveshjes kuadër, në (LEK) pa TVSH				9,933,334	???

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (kërkuar në dokumentat e tenderit)

Klasifikimi përfundimtar i operatorëve ekonomikëtë suksesshëm në marrëveshjen kuadër do të bëhet sipas çmimit total të ofertës referuar sasive të pritshme të përcaktuara në shtojcën 12 të DT –së (Sasia dhe grafiku i lëvrimit),ndërsa:

Në DT (Dokumentat e Tenderit) për uniformat e Policisë së Shtetit, tregohet:

ISHTE – Për procedurën datë 19.08.2019, pezulluar.

Shtojca 3

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit _____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-se

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

Tabela e mëposhtme është me shkurtime, e plotë gjendet në DT (Dokumentat e Tenderit), të procedurës datë 19.08.2019, fillon nga Nr.Rendor 1 (Xhup shërbimi (3/4)(me veshje të ngrohtë), mbaron Nr.Rendor 123 (Këpuçë taktike verore për strukturat e veçanta) + + +

Nr.	Përshkrimi i Mallit	Njësi	Sasia ?	Çmimi/Njësi
I	UNIFORMA BAZË			

1	Xhup shërbimi (3/4)(me veshje të ngrohtë)	Copë	1	
deri 123	Këpucë taktike verore për strukturat e veçanta	Palë	1	
Shumatorja limit e çmimeve për njësi të uniformës (Lekë pa TVSH)				488,141
XII	SISTEMI ELEKTRONIK I SHPËRNDARJES SË UNIFORMËS			
1	Sistemi elektronik (ëeb, aplikacioni, programi)	Copë	1	
2	Karta për punonjësit e Policisë	Copë	1	
3	Trajnime	Javë	1	
4	Mirëmbajtja	Vite	1	
Shumatorja limit e çmimeve për njësi të sistemit të shpërndarjes (Lekë pa TVSH)				21.494. 225
Shumatorja limit e çmimeve për njësi, në total (Lekë pa TVSH)				21,982,366

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

Vlerësimi i Ofertës Ekonomike do të bëhet duke u bazuar vetëm në çmimin për njësi. Pikët maksimale do t'i jepen ofertuesit i cili paraqet shumatoren e çmimeve për njësi më të ulët (të artikujve të uniformës dhe të zërave të sistemit elektronik të shpërndarjes së uniformës). Në cdo rast, operatorët ekonomik duke iu referuar sasive të pritshme përkatëse, **nuk duhet të tejkalojnë** as shumatoren limit të artikujve të uniformës, **as fondin limit të sistemit elektronik të shpërndarjes së uniformës**, dhe as vlerën e pritshme të kontratës (fondin limit të marrëveshjes kuadër).

BËHET – Për procedurën e rihapur datë 5.11.2019

Shtojca 3

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit _____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-se

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

Tabelave e mëposhtme është me shkurtime, e plotë gjendet në DT (Dokumentat e Tenderit), të procedurës së rihapur datë 5.11.2019, fillon nga Nr.Rendor 1 (Xhup shërbimi (3/4)(me veshje të ngrohtë), mbaron Nr.Rendor 123 (Këpucë taktike verore për strukturat e veçanta)

Nr.	Përshkrimi i Mallit	Njësi	Sasia ?	Çmimi/Njësi
I	UNIFORMA BAZË			
Nr. 1	Xhup shërbimi (3/4)(me veshje të ngrohtë)	Copë	1	
deri 123	Këpucë taktike verore për strukturat e veçanta	Palë	1	
Shumatorja limit e çmimeve për njësi, në total (Lekë pa TVSH)				621.011???

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

Vlerësimi i Ofertës Ekonomike do të bëhet duke u bazuar vetëm në shumatoren e çmimeve për njësi. Pikët maksimale do t'i jepen ofertuesit i cili paraqet shumatoren e çmimeve për njësi më të ulët. Në cdo rast, operatorët ekonomik duke iu referuar sasive të pritshme përkatëse, nuk duhet të tejkalojnë as shumatoren limit të artikujve të uniformës dhe as vlerën e pritshme të kontratës (fondin limit të marrëveshjes kuadër).

Tek shtojcës 3 “Formulari i Ofertës Ekonomike” në dokumentat e tenderit: Për Procedurën e rihapur datë 5.11.2019:

HIQETpika XII “SISTEMI ELEKTRONIK I SHPËRNDARJES SË UNIFORMËS”, si më poshtë:

XII	SISTEMI ELEKTRONIK I SHPËRNDARJES SË UNIFORMËS	NJËSIA	SASIA	CMIMI/ NJËSI
1	Sistemi elektronik (ëeb, aplikacioni, programi)	Copë	1	
2	Karta për punonjësit e Policisë	Copë	1	
3	Trajnime	Javë	1	
4	Mirëmbajtja	Vite	1	
Shumatorja limit e çmimeve për njësi të sistemit të shpërndarjes (Lekë pa TVSH)				21.494. 225?

Në tabelëHIQET rreshti:

Shumatorja limit e çmimeve për njësi të uniformës (Lekë pa TVSH)		488,141?
---	--	-----------------

Në tabelë ISHTE rreshti:

Shumatorja limit e çmimeve për njësi, në total (Lekë pa TVSH)	21,982,366?
---	-------------

Në tabelë BËHET rreshti:

Shumatorja limit e çmimeve për njësi, në total (Lekë pa TVSH)	621.011?
---	----------

Paragrafi i fundit në Shtojcën 3 - ISHTE: Për procedurën datë 19.08.2019, pezulluar.

Vlerësimi i Ofertës Ekonomike do të bëhet duke u bazuar vetëm në çmimin për njësi. Pikët maksimale do t'i jepen ofertuesit i cili paraqet shumatoren e çmimeve për njësi më të ulët (të artikujve të uniformës dhe të zërave të sistemit elektronik të shpërndarjes së uniformës). Në cdo rast, operatorët ekonomik duke iu referuar sasive të pritshme përkatëse, nuk duhet të tejkalojnë as shumatoren limit të artikujve të uniformës, as fondin limit të sistemit elektronik të shpërndarjes së uniformës, dhe as vlerën e pritshme të kontratës (fondin limit të marrëveshjes kuadër).

Paragrafi i fundit në Shtojcën 3 - BËHET: Për procedurë e rihapur datë 5.11.2019

Vlerësimi i Ofertës Ekonomike do të bëhet duke u bazuar vetëm në shumatoren e çmimeve për njësi. Pikët maksimale do t'i jepen ofertuesit i cili paraqet shumatoren e çmimeve për njësi më të ulët. Në cdo rast, operatorët ekonomik duke iu referuar sasive të pritshme përkatëse, nuk duhet të tejkalojnë as shumatoren limit të artikujve të uniformës dhe as vlerën e pritshme të kontratës (fondin limit të marrëveshjes kuadër). Pra është hequr **fondi limit të sistemit elektronik të shpërndarjes së uniformës???**

Tek Shtojca 13 "SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT" - ISHTE tabela "Për sistemin elektronik të shpërndarjes së uniformës" **Për procedurën datë 19.08.2019**, pezulluar, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i artikullit	Njësia Matëse	Sasia e pritshme
1	Sistemi elektronik i shpërndarjes (ëeb, aplikacion, program)	Copë	1
2	Karta për punonjësit e Policisë	Copë	10000
3	Trajnime	Javë	4
4	Mirëmbajtja	Vite	4

Tek Shtojca 13 "SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT" - HIQET tabela "Për sistemin elektronik të shpërndarjes së uniformës" **Për procedure e rihapur date 5.11.2019**, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i artikullit	Njësia Matëse	Sasia e pritshme
1	Sistemi elektronik i shpërndarjes (ëeb, aplikacion, program)	Copë	1
2	Karta për punonjësit e Policisë	Copë	10000
3	Trajnime	Javë	4
4	Mirëmbajtja	Vite	4

Pra, shuhen: Sistemi elektronik i shpërndarjes (ëeb, aplikacion, program), **10000 Karta**, me anën e së cilës çdo punonjës të Policisë do të pajiseshin me Karta, për të tërhequr uniformat e tyre, si dhe trajnime e mirmbajtje. ???

Tek Shtojca 11 “Specifikimet Teknike” të dokumentave të tenderit, pika 6 “Shpërndarja”:

ISHTE: Në procedurën e datës 19.08.2019

Operatori ekonomik fitues do të realizojë shpërndarjen e artikujve të uniformës tek punonjësit e policisë, nëpërmjet pikave fikse të shpërndarjes në cdo qendër qarku dhe pikave të lëvizshme të shpërndarjes pranë cdo njësie shpenzuese të Policisë së Shtetit (40-50 njësi shpenzuese).

Për qarkun Tiranë do të realizojë shpërndarjen e artikujve të uniformës tek punonjësit e policisë, nëpërmjet minimalisht **5(pesë) pikave fikse të shpërndarjes, ndërsa për 11 qarqet** e tjera do ta realizojë nëpërmjet minimalisht **1 (një) pike shpërndarje fikse për cdo qendër qarku.**

BËHET: Në procedurën e rihapur datë 5.11.2019

Operatori ekonomik fitues do të realizojë shpërndarjen e artikujve të uniformës tek punonjësit e policisë, sipas përcaktimeve të Aneksit 9 - i ndryshuar - Sistemi Elektronik i Shpërndarjes.???

Pra shuhen dhe 16 pika fikse të shpërndarjes së artikujve të uniformës tek punonjësit. **Lehtësohet**

Operatori ekonomik fitues, nga pagesat e qerasë të ambjenteve në 16 pika fikse të shpërndarjes së artikujve të uniformës tek punonjësit e policisë???

Shtojca 3 Në procedurën e rihapur datë 5.11.2019

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE

Emri i Ofertuesit _____

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr.Referencës në faqen e APP-se

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

3. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
4. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

Tabelave e mëposhtme është me shkurtime, e plotë gjendet në DT (Dokumentat e Tenderit), të procedurës së ri hapur datë 5.11.2019, fillon po nga Nr.Rendor 1 (Xhup shërbimi (3/4)(me veshje të ngrohtë), mbaron Nr.Rendor 123 (Këpucë taktike verore për strukturat e veçanta)

Nr.	Përshkrimi i Mallit	Njësi	Sasia ?	Çmimi/Njësi
I	UNIFORMA BAZË			
Nr. 1	Xhup shërbimi (3/4)(me veshje të ngrohtë)	Copë	1	
deri 123	Këpucë taktike verore për strukturat e veçanta	Palë	1	

Shumatorja limit e çmimeve për njësi, në total (Lekë pa TVSH)	621.011???
--	-------------------

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

Vlerësimi i Ofertës Ekonomike do të bëhet duke u bazuar vetëm në shumatoren e çmimeve për njësi. Pikët maksimale do t'i jepen ofertuesit i cili paraqet shumatoren e çmimeve për njësi më të ulët. Në cdo rast, operatorët ekonomik duke iu referuar sasive të pritshme përkatëse, nuk duhet të tejkalojnë as shumatoren limit të artikujve të uniformës dhe as vlerën e pritshme të kontratës (fondin limit të marrëveshjes kuadër).

Në tabelën e mësipërme Sasia (nga 1 për llojet e uniformave, gradave, stemave, shenjave dhe këpucë të Policisë së Shtetit, gjithsej 123, vetëm aksesoret/gradat/stemat/shenjat janë 50) dhe Çmimi/njësi. Ndërsa referuar sasive të pritshme të përcaktura në shtojcën 13 të DT –së (Sasia dhe grafiku i lëvrimit), si më poshtë:

BËHET: Për procedurën e rihapur datë 5.11.2019, ndryshuar, Nr.123, nga të cilat: 50 janë aksesoret, gradat, stemat e shenjat e Policisë së Shtetit.

ISHTE: Për procedurën datë 19.08.2019, pezulluar, gjithsej total: ===== 142,679

Për procedurën e rihapur datë 5.11.2019, ndryshuar, gjithsej total: ===== 138,679, do të blihen më pak gradat, stemat e shenjat e Policisë së Shtetit. Ose do të blihen në total 4,000 aksesoret, gradat, stemat e shenjat në procedurën e rihapur, të cilat mendohet të vlerësohen në 6,500,000 lekë, vlerë e papëfillshme që operatorët ekonomik dyshohet të jetë ulur shumatorja e çmimeve për njësi.

SHUMATORJA E ÇMIMEVE PËR NJËSI SKEMË "MAFIOZE" - VJEDHJE

Vlerësimi i Ofertës Ekonomike do të bëhet duke u bazuar vetëm në shumatoren e çmimeve për njësi, ka kamufluar Fondin limit: 2,800,347,570 lekë pa TVSH, që është hapur procedura e tenderimit, Objekti i marrëveshjes kuadër: "Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit". Pikërisht këtu bëhet loja me Vlerësimin i Ofertës Ekonomike, sepse do të bëhet duke u bazuar vetëm në shumatoren e çmimeve për njësi???, dhe jo sipas cmimit total të ofertës referuar sasive të pritshme.

Ja si është luajtur me shumatoren e çmimeve për njësi, kur objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj.

Po, në **SHTOJCË NR. 1**, datë **15.10.2019**, të Agjencisë Blerjeve të Përqendruara, në Ministrinë e Brendshme, në ndryshimet dhe modifikimet në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit të datës 19.08.2019 të pezulluar bie në sy se. në procedurën e rihapur më datë 5.11.2019, është rritur shumatorja e çmimeve për njësi, si më poshtë:

Tek Njoftimi i Kontratës, Seksioni 2 "Objekti i kontratës", nënseksioni 2.8 "Përshkrim i shkurtër i marrëveshjes kuadër", pikat 2 dhe 4:

ISHIN: Në procedurën datës **19.08.2019** të pezulluar, si më poshtë:

Në rastin kur objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, shumatorja e çmimeve për njësi është: 21.982.366 (njëzetënjëmilion e nëntëqind e tetëdhjetëedymijë e treqindëgjashtëdhjetëegjashtë) Lekë (pa TVSH), ku përfshihet:

- **Shumatorja e çmimeve për njësi** të artikujve të veshjeve dhe këpucëve: **488.141** (katërqind e tetëdhjetë e tetëmijë e njëqind e dyzetë e një) Lekë (pa TVSH).
- Objekti i marrëveshjes kuadër: "Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit", **për 4 vjet (2019-2022).**

Sipas DT (dokumentat e Tenderit), Shtojca 3 [Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik] FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE, në tabelë kërkohet:

Përshkrimi i mallit (pasqyrohen llojet e uniformave, llojet e gradave dhe këpucë), **Njësi** (copë/komplet/palë), **Sasia** (nga 1 për llojet e uniformave, gradave, stemave, shenjat dhe këpucë, gjithsej 123 numri i artikujve **vetëm aksesoret/gradat/stemat/shenjat janë 50**) dhe Çmimi/njësi.

Tabela mbyllet:

Shumatorja e çmimeve për njësi të uniformës(Lekë pa TVSH), **481,141**.

Shumatorja limit e çmimeve për njësi të sistemit të shpërndarjes (Lekë pa TVSH),21.494.

225 Shumatorja limit e çmimeve për njësi, në total (Lekë pa TVSH),21,982,366

BËHEN: Në procedurën e rihapur më datë **5.11.2019**, si më poshtë:

Në rastin kur objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, shumatorja e çmimeve për njësi është: **621.011** (gjashtë qind e njëzetë e një mijë e njëmbëdhjetë) Lekë (pa TVSH).

Objekti i marrëveshjes kuadr: “Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit”, **për 4 vjet**.
???

Sipas DT (Dokumentat e Tenderit, të **ndyshuar**), Shtojca 3 [Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik] FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE, në një tabelë kërkohet:

Përshkrimi i mallit (pasqyrohen llojet e uniformave, llojet e gradave dhe këpucë), **Njësi** (copë/komplet/palë), **Sasia** (nga 1 për llojet e uniformave, gradave dhe këpucë, gjithsej 123, **vetëm aksesorët/gradat/stemat/shenjat janë 50**) dhe Çmimi/njësi.

Tabela mbyllet:

Shumatorja e çmimeve për njësi të uniformës (Lekë pa TVSH), **621.011**

Dyshohet se nëpërmjet përdorimit të skemës “mafioze”, shumatorja e çmimeve për njësi”, grabitja nga uniformat e Policisë së Shtetit mund të shkojë dhe në 1,157,815,852 lekë

Për arsye, sepse nuk mund të jepet çmimi për njësi. P. Shembull: **15,500 Komplete Kostum uniforme (1 Xhaketë, 2 pantallona, 2 kapele)** të planifikuara për blerje **me një çmim jo më pak se 25,000 lekë** pa TVSH, që po të llogaritim vlerën e kësaj sasi kostume në bazë të planifikimit, **kap vlerën 377,500,000 lekë pa TVSH**.

Në shumatore çmimi për njësi merr një vlerë në bazë të % të barabartë me një artikull tjetër ku çmimi për njësi është e papërfillshme, konkretisht: **6 palë Grada ”Drejtues Madhor”** të planifikuara për blerje **me një çmim jo më pak se 2,500 lekë** pa TVSH, vlera totale e tyre është **15,000 lekë** pa TVSH.

Në ofertën ekonomike të paraqitur nga Operatorët, **vlerësimi është i njëjtë** si me Kostum uniforme(1 Xhaketë, 2 pantallona, 2 kapele), po kështu dhe me Gradat ”Drejtues Madhor”.

KVO (Komisioni i Vlerësimit të Ofertave) kur bënë vlerësimin, i jep të njëjtat pikë si për Kostum uniforme ashtu dhe për Gradat ”Drejtues Madhor”, konkretisht:

Operatori Ekonomikë, **ofron Kostum uniforme 25,000 lekë** pa TVSH dhe merr vlerësimin maksimal, ndërsa për Gradat ”Drejtues i Lartë ofron 1 lekë dhe një vlerësim minimal. Po ti bashkojmë të dy çmimet për njësi, do të na dalë rreth 51 % të ofrohet të çmimit për njësi.

Në realitet, kur lidhet kontrata me Operatorin Ekonomikë fitues, çmimi për njësi **nuk do të jetë 51%** i vlerës totale të dy artikujve, **por do të jetë 99 %**, sepse Kostum uniforme është ofruar me vlerë të plotë. Operatori Ekonomik**“D&E”, fitues i tenderit** fitues i Tenderit, **për aksesorët/gradat, stemat e shenjat**, çmimet e tyre në krahasim me çmimet e planifikuara që është rihapur procedura e tenderit datë 5.11.2020, **ka vendosur çmime të papërfillshme**.

TENDERI I UNIFORMAVE TË POLICISË SË SHTETIT

Më datë 11.05.2020 Agjencia e Blerjeve të Përqendruara në Ministrinë e Brendshme, ka hapur ofertat ekonomike, vetëm për kandidatët e përzgjedhur në **Faza I - Parakualifikimi**, konkretisht:

Bashkimin e Operatorëve Ekonomik: **”KAP-KO d.o.o”** + **“ODJECA d.o.o”** + **“GALKO d.o.o”** + **“JELEN PROFESSIONAL d.o.o”** + **“GALEB d.d”** + **“OPENTECH CONSULTING & SERVICES SHPK”**. Adresa e përfaqësuesit të BOE-së **”KAPKO d.o.o”**: Garešnička 22, 10040, Zagreb, **Kroatia**.

Genç Taahhüt Giyim Tekstil İnşaat San. Ve Tic. Ltd. Sti. Adresa: Refahiye Mah. 281. Sk. No: 9/2 Selim Apt. Haliliye / Sanliurfa, **Turkiye**.

Bashkimin e Operatorëve Ekonomik: "D&E SHPK" + "SUMMER CONF. s.r.l" + "LOVERS s.r.l" + "YAKUPOGLU TEKSTIL VE DERI SAN. TIC. AS A. VEDAT YAKUPOGLU".

Adresa e përfaqësuesit të BOE-së **"D&E SHPK"**: Rruga "Milto Tutulani", Pallati Alb Millenium, nr.6, Kati 1, **Tiranë**.

Më datë 14.07.2020, Agjencia e Blerjeve të Përqendruar, në Ministrinë e Brendshme, publikon Formularin e Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Sukseshëm në Marrëveshjen Kuadër. Ky Njoftim **është publikuar dhe në Buletini Nr.43 datë 20 Korrik 2020**-Agjencia e Prokurimit Publik. **Janë ka s'kualifikuar:**

1. Bashkimin e Operatorëve Ekonomik: "KAP-KO d.o.o" + "ODJECA d.o.o" + "GALKO d.o.o" + "JELEN PROFESSIONAL d.o.o" + "GALEB d.d" + "OPENTECH CONSULTING & SERVICES SHPK".

Adresa e përfaqësuesit të BOE-së **"KAPKO d.o.o"**: Garešnička 22, 10040, Zagreb, **Kroatia**.

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar: 446,667 (katërqind e dyzetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë (pa TVSH) (me numra dhe fjalë), ose është ofruar **72%** të shumatores limit të çmimeve për njësi: **621,011 lekë**, që është rihapur procedura e tenderimit datë 5.11.2019.

Nga përlllogaritjet sipas shumatores limit të çmimeve për njësi, **Bashkimin e Operatorëve Ekonomik: "KAP-KO d.o.o"** +....., **mendohet të jetë ofruar rreth 2,700,000,000 lekë**, ose është ofruar **100,347,570 lekë** më pak **përkundrejt fondit limit: 2,800,347,570 lekë**, që është rihapur procedura e tenderimit datë 5.11.2019.

Bashkimin e Operatorëve Ekonomik: "KAP-KO d.o.o" + + + + +, është s'kualifikuar se, *Nuk plotëson kriterin e përcaktuar në pikën 13 të ofertës teknike, pasi ditën e hapjes së procedurës nuk arriti të paraqesë mostrat / kampionet të disa prej artikujve që kërkohen të prokurohen,!* **Normalisht nuk kishte se si të realizonte mostrat / kampionet (104 të tilla kërkoheshin, për t'u paraqitur), sepse afati përgatitjes së tyre ishte përcaktuar, që të realizoheshin për 20 ditë?, pas përzgjedhjes, kualifikimit në fazën e parë.**

2. Genç Taahhüt Giyim Tekstil İnşaat San. Ve Tic. Ltd. Sti. Adresa: Refahiye Mah. 281. Sk. No: 9/2 Selim Apt. Haliliye / Sanliurfa, **Turkiye**.

Shumatorja e çmimeve për njësi e ofruar: 133,480 (njëqind e tridhjetë e tre mijë e katërqind e tetëdhjetë) Lekë (pa TVSH) (me numra dhe fjalë), ofruar **21,5%** të shumatores limit të çmimeve për njësi: **621,011 lekë**, që është rihapur procedura e tenderimit datë 5.11.2019.

Nga përlllogaritjet sipas shumatores limit të çmimeve për njësi, **Genç Taahhüt Giyim Tekstil İnşaat San. Ve Tic. Ltd. Sti.** **mendohet të jetë ofruar rreth 2,100,000,000 lekë**, ose është ofruar **700,347,570 lekë** më pak **përkundrejt fondit limit: 2,800,347,570 lekë**, që është rihapur procedura e tenderimit datë 5.11.2019.

Ndërsa, **Genç Taahhüt Giyim Tekstil İnşaat San. Ve Tic. dhe Bashkimin e Operatorëve Ekonomik: "D&E" SHPK** + "SUMMER CONF. s.r.l" + +, lëre se çfarë thonë (këto dy kompani bashkëpunojnë bashkë), **për të realizuar mostrat / kampionet (104 të tilla kërkoheshin, për t'u paraqitur), në afat për 20 ditë, pas përzgjedhjes, kualifikimit në fazën e parë, këtyre dy kompanive u vjen në ndihmë firma Marsi&AL shpk, me ortakët Misar Tufi dhe Petrit Kasapi.**

Më datën 15.10.2019, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, në Ministrinë e Brendshme ka publikuar zyrtarisht, **SQARIME NR.1** "Mbi dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit, "Procedurë e Kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar" me objekt: "Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit", duke bërë shumë sqarime, ku ndër të tjera sqaron se: **Afati minimal i përcaktuar në ligj për dorëzimin e ofertave në fazën e dytë është 20 ditë.**

Mirpo dhe procedura e rihapur e datës 5.11.2019 pezullohet për një moment. Sepse në Komisionin e Prokurimit Publik ka paraqitur ankesë **Operatori ekonomik "Marsi & AI" sh.p.k. me Objekt: Modifikimi i dokumentave** të procedurës së prokurimit "Procedurë e Kufizuar-Marrëveshje Kuadër", me nr. REF-31606-07-25-2019, me objekt "Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit", me fond limit 2.800.347.570 lekë (pa

TVSH), **parashikuar për t'u zhvilluar në datën 05.11.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara**".

Komisioni i Prokurimit Publik (K.P.P.) në mbledhjen e datës 19.12.2019 shqyrtoi ankesën e Operatorit ekonomik "Marsi & Al" sh.p.k. dhe **me Vendim 790/2019, vendosi:**

1. **Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Marsi & Al" sh.p.k.**, për procedurën e prokurimit "Procedurë e Kufizuar-Marrëveshje Kuadër", me nr. REF-31606-07-25-2019, me objekt "Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit", me fond limit 2.800.347.570 lekë (pa TVSH), parashikuar për t'u zhvilluar në datën 05.11.2019, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.
2. **Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së mësipërme të prokurimit**

Operatori ekonomik "Marsi & Al" e bëri ankesën për llogari të "D&E" SHPK, për të patur kohën e mjaftueshme në përgatitjen e mostrave të uniformave dhe këpucëve, etj, që duhet të paraqiteshin në procedurën e tenderimit, sepse rreth 100 mostra të artikujve të uniformës, këpucëve, etj, **nuk mund të realizoheshin për 20 ditë? dhe në kohë pandemie.**

Komisioni i Prokurimit Publik (K.P.P.), është bërë palë Operatorin ekonomik "Marsi & Al", sepse më parë është publikuar **me SHTOJÇË NR. 1, datë 15.10.2019**, nga Agjencia Blerjeve të Përqëndruara, në Ministrinë e Brendshme, Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit dhe ndryshimi i specifikimet teknike të artikujve të uniformës së Policisë së Shtetit.

Operatori ekonomik "Marsi & Al, nuk mori pjesë në procedurën e tenderimit të uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit, **por dokumentacionin e firmës Turke "YAKUPOGLU TEKSTIL VE DERI SAN. TIC. AS A. VEDAT YAKUPOGLU"**, që **"Marsi & Al përdori** për objekt "Blerje uniforma ushtarake dhe pjesët përbërëse të tyre" në Ministrinë së Mbrojtjes, **e përdori "D&E" SHPK**, në tenderin me objekt "Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit", me fond limit: 2.800.347.570 lekë (pa TVSH), që u zhvillua më datë 11.05.2020.

"D&E" shpk dhe "Marsi & Al" shpk, janë bashkëpunëtor dhe veprojnë si skemë "mashtriuese". Këtë fakt e tregon dhe QKB (Qendra Kombëtare e Bisnesit), Ekstrakt historik i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit SH.P.K., Gjendja e Regjistrimit, **rezulton se, "D&E" shpk dhe "Marsi&AL" shpk, të kenë të njëjtin nr.telefoni 0682008631???**

Më datë 14.07.2020 Agjencia e Blerjeve të Përqëndruar, në Ministrinë e Brendshme, **mes "formaliteteve, lojrave e manovrave"**, ka shpallur fitues, **Shoqërinë shqiptare "D&E SHPK"**, me aktivitet **"gërmime dheu"**, si më poshtë:

3.**Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: "D&E" SHPK dhe "SUMMER CONF. s.r.l"** dhe "LOVERS s.r.l" dhe "YAKUPOGLU TEKSTIL VE DERI SAN. TIC. AS A. VEDAT YAKUPOGLU",respektivisht me NIPT: K71804001C; RO8145996; 00235470135; 9290313472;

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar: 319,966 (treqind e nëntëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) Lekë (pa TVSH) (me numra dhe fjalë) dhe me pikë totale të marra 70 (shtatëdhjetë) pikë, ofruar **51,5%** të shumatores limit të çmimeve për njësi: **621,011 lekë**, që është rihapur procedura e tenderimit datë 5.11.2019

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se jane identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë organit qendror blerës Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara, me adresë:Ministria e Brendshme, Sheshi Skënderbej, nr.3, Tiranë, Tel: 042247865, **brenda 5(pesë) ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi, për të lidhur marrëveshjen kuadër**, përfundon njoftimin Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara në Ministrinë e Brendshme, të datës 14.07.2020.

Nga përlllogaritjet sipas shumatores limit të çmimeve për njësi, **Bashkimin e Operatorëve Ekonomik: "D&E" SHPK + "SUMMER CONF. s.r.l" + +, mendohet të jetë ofruar rreth 2,600,000,000 lekë, ose është ofruar**

200,347,570 lekë më pak **përkundrejt fondit limit: 2,800,347,570 lekë**, që është rihapur procedura e tenderimit datë 5.11.2019.

Me çmimet që ka ofruar, sipas marrveshjes-kuadër, **"D&E" SHPK** dhe diferencën prej **200,347,570 lekë**, ka për ti marrë, sepse po rritet numri policëve dhe kanë nevoja të normuara ata për tu veshur.

Një gjë është e dyshimtë: **"D&E SHPK", me 51,5 %** që është ofruar, për kundrejt fondit limit: **2,800,357,570 lekë** që është rihapur procedura e datës 5.11.2019, normalisht duhet **të lidh kontratën me 1,442,184,148 lekë?**, por në fakt **do ta lidh kontratën me rreth 2,600,00,000 lekë**, çka do të thotë **sipas skemës "mafioze" të shumatores limit të çmimeve për njësi, dyshohet sipas kësaj skeme të përdorur, vjedhja mund të shkojë dhe në 1,157,815,852 lekë** nga Tenderi i dyshimtë të uniformave të Policisë së Shtetit.

Një fakt tjetër interesant! Në **Noftimin** e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara në Ministrinë e Brendshme, të datës 14.07.2020?, **ka ikur me kohë 1 Prilli**, po ofron të **iki dhe 1 Shtatori**, kërkohet që brenda 5(pesë) ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi, për të lidhur marrëveshjen kuadër.

Por në këtë njoftim tregohet se, **Afati kohor i ekzekutimit:** Brenda datës **1 Prill për artikujt e uniformës verore?** dhe brenda datës **1 Shtator për artikujt e uniformës dimërore?** Përrjashtimisht, afati kohor për ekzekutimin e kontratës së parë që do të nënshkruhet brenda Marrëveshjes Kuadër, do të jetë jo më pak se 60 ditë nga lidhja e kontratës së parë.

Një gjë është e sigurtë se, **Shoqëria shqiptare "D&E" shpk**, ka marrë garanci paraprake nga autoritetet dhe ka filluar prodhimin e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit, etj?, Menjëherë pas lidhjes së kontratës, do të filloj të dorëzojë në hambarët e Policisë në Mullet Tiranë, si fillim **do të dorëzojë aksesorët/gradat/stemat/shenjat**, etj, (kjo është më se e verifikueshme), nëpërmjet faturës shitje të **Shoqëria "D&E" shpk**).

Shoqëria shqiptare "D&E" shpk

Nga Qendra Kombëtare e Bisnesit, Gjendja e Regjistrimit, "D&E" shpk, rezulton me të dhënat e poshtëme:
Administratori Ismail Kadiu i subjektit "D&E" shpk, Numri unik i identifikimit të subjektit(NUIS), K71804001C, Data e Regjistrimit dhe Data e themelimit 24/05/2007, Objekti eaktivitetit: **1.Imp-exp artikuj ndryshëm industriale.2.Gërmime, ndërtime ndryshme**, impiant teknologjike, etj, Import Eksport, Gjeneral kontraktor në sektorin e ndërtimeve, të tregtisë dhe të shërbimeve **të prodhimit për artikuj veshje pune, ushtarake???**, impiante teknologjike, elektrike, kondicionimi, aspirimi dhe hidraulike.**Prodhime aplikacione software dhe sistemesh për menaxhimin e shpërndarjes së uniformave dhe mallrave???**. Tregtim, armë, municione dhe pajisje të ndryshme ushtarake. **Ortakët Ismail Kadiu.**

Në Dokumentat e ndryshuara të Tenderit, rihapur datë 5.11.2019 "Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit", tek "KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT", kërkohet:

Pika 3.Ofertuesi duhet të deklarojë personelin kryesor teknik për zbatimin e objektit të prokurimit, përsa i përket krijimit, zhvillimit, instalimit, mirëmbajtjes të sistemit elektronik të shpërndarjes së uniformës dhe trajnimit për përdorimin e sistemit, si dhe të paraqesë dokumentacionin: CV, librezë pune, kontratë pune dhe diplomë për shkenca kompjuterike, informatike, elektronike ose ekuivalente, punonjës për testim aplikacioneshpër personelin.

Në Faza 1 – Parakualifikimi, për kërkesat e kualifikimit të përcaktura në dokumentat e tenderit, se përfaqësuesit të BOE-së **"D&E" SHPK....., duke mos patur aktivitet: Prodhime aplikacione software dhe sistemesh për menaxhimin e shpërndarjes së uniformave dhe mallrave**, pretendohet se **"D&E" SHPK, dyshohet se ka paraqitur Dokumentat e një kompanie tjetër, që plotëson kërkesat e pikës 3.**

Nga Qendra Kombëtare e Bisnesit, Gjendja e Regjistrimit, "D&E" shpk, jo vetëm që mashtron me të dhënën:Prodhime aplikacione software dhe sistemesh për menaxhimin e shpërndarjes së uniformave dhe mallrave, por mashtron dhe me të dhënën: të prodhimit për artikuj veshje pune, ushtarake."D&E" shpk, nuk dispon të ketë në pronësi ambjente për rrobaqepsi, makineri e pajisje (nuk ka listë të tyre të deklaruara në organet tatimore), të prodhimit për artikuj veshje pune, ushtarake, nuk ka të siguruar punëtor (nuk ka listë të tyre të deklaruara e të derdhura në organet e sigurimeve shoqërore), që merren me prodhimin e këtyre veshjeve). Kjo mund të verifikohet lehtësisht nga institucionet përkatëse, të larpërmendur.

Procedura e rihapur e tenderit më datë 5.11.2019 “Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit”, **për 4 vjet, në vlerën prej 2.800.347.570 lekë** pa TVSH dhe zhvilluar në datën 11.05.2020, DT (Dokumentat e Tenderit dhe Specifikimet teknike), **i kanë brenda elementet e shpërdorimit të detyrës e korrupsionit, skemat “mafioze”, abuzivitetin, mashtrimin, fasifikimin, dhe kamuffimin.**

Ekzistojnë mjaftueshëm faktet dhe prova materiale, se Ministria e Brendshme ka qenë e parapërgatitur dhe e vendosur nga tenderi i hapur për blerjen e uniformave të Policisë së Shtetit, në vlerën prej 2,800,347.570 lekë, për të grabitur hapur vlerën 500,000,000 lekë parashikuar që në DT (Dokumentat e Tenderit).

Kemi bindjen e plotë se, Prokuroria e Përgjithshme, SPAK (Struktura Posaçme Antikorrupsion), dhe KLSH (Kontrolli i Lartë i Shtetit), do të konfikscojë gjithë praktikatat dhe korespondencën e Agjencisë së Blerjeve të Perqendruara, në Ministrinë e Brendshme **dhe do të nis hetimin e menjëhershëm të dosjes së tenderit 4 vjeçar të uniformave të Policisë së Shtetit, në vlerën prej 2.800.347.570 lekë** pa TVSH (3,360,417,084 lekë me TVSH), me këtë përmbajtje:

Dosja e tenderit

Të dhënat kryesore
Dokumentet e Njoftimit
Dokumentet e Tenderit

- Objekti i tenderit :
“Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit
- Autoriteti kontraktues :
Agjencia e Blerjeve te Perqendruara
Fituesi: D&E
Rezultati: 319,966,00 lekë
NIPT: k71804001C
- Procedura :
E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar
- Tipi i kontratës :
Mallra
- Numri i referencës :
REF-31606-07-25-2019
- Numri i Njoftimit :
CN/84224/07252019
- **Fondi limit :**
2,800,347,570.00 Lekë
- Data e publikimit :
26-07-2019 Ora : 09:58
- **Data e hapjes :**
26-07-2019 Ora : 08:00
- **Data e mbylljes :**
11-05-2020 Ora :11:00
- Pezulluar :
Jo (**në fakt Po**), **veçse ta kenë fshirë nga serveri Po-në ?**
- Kodi CPV :
 - BID INVITATION -KAPKO- Police Uniforms.docx
 - Aneksi Nr.7 Kepuce.pdf **ISHTE** në procedurën datë 19.08.2019, pezulluar.
 - BID INVITATION -GencTahut- Police Uniforms.docx
 - BID INVITATION -DE- Police Uniforms.docx
 - Aneksi Nr.9 Sistemi elektronik.docx **ISHTE** në procedurën datë 19.08.2019, pezulluar.
 - Ftese per Oferte -KAPKO- Uniforma DPPSH.docx**
 - Annex no.5- amended- Jacket and Winter suits.pdf

- Tender Documents - Amended.docx
- Aneksi nr.8 - indryshuar – Grada Shenja Stema.pdf **BËHET** në procedurën e rihapur, datë 5.11.2019.
- Aneksi nr.5 – i ndryshuar - Xhupat.pdf **BËHET** në procedurën e rihapur, datë 5.11.2019.
- Annex no.3-amended-Ripstop.pdf
- Aneksi nr.3 – i ndryshuar - Materiale doku.pdf **BËHET** në procedurën e rihapur, datë 5.11.2019.
- Aneksi Nr.6 Aksesore.pdf **ISHTE** në procedurën datë 19.08.2019, pezulluar.
- Aneksi Nr.3 Materiale Doku.pdf **ISHTE** në procedurën datë 19.08.2019, pezulluar.
- Aneksi Nr.8 GradatShenja Kordona.pdf **ISHTE** në procedurën datë 19.08.2019, pezulluar.
- njoftim datë 08.04.2019.docx
- Annex no.1-amended- Costumes.pdf
- Annex no.2 - amended - Shirts Group.pdf
- Clarification no.1.docx
- Dokumentat e Tenderit - te ndryshuara.docx **BËHET** në procedurën e rihapur, datë 5.11.2019.
- Aneksi Nr.4 Trikotazhe.pdf **ISHTE** në procedurën datë 19.08.2019, pezulluar.
- DT- UNIFROMA- ENG.docx
- NOTIFICATION date 08.04.2020.docx
- Aneksi nr.2 - indryshuar - Këmisha.pdf **BËHET** në procedurën e rihapur, datë 5.11.2019.
- Annex No.8 Insignia Badges and Cords .pdf
- Aneksi nr.1 – i ndryshuar – Kostume.pdf **BËHET** në procedurën e rihapur, datë 5.11.2019.
- Aneksi Nr.5 Xhupat.pdf **ISHTE** në procedurën datë 19.08.2019, pezulluar.
- Annex no.8 – amended- Insignia Badges and Cords.pdf
- Aneksi Nr.1 Kostume.pdf **ISHTE** në procedurën datë 19.08.2019, pezulluar.
- Annex No.3 Ripstop.pdf
- Annex No.6 Accessories.pdf
- Annex No.5 Jacket and Winter Suits.pdf
- Annex No.9 ELECTRONIC DELIVERY SYSTEM.docx
- Aneksi nr.4 – i ndryshuar - Trikotazhe.pdf **BËHET** në procedurën e rihapur, datë 5.11.2019.
- Ftese per Oferte – Gene Tahut - Uniforma DPPSH.docx**
- Annex No.2 Shirts.pdf
- Aneksi nr.9 - indryshuar – Sistemi Elektronik i Shpërndarjes.docx **BËHET** në procedurën e rihapur, datë 5.11.2019.
- Ftese per Oferte - DE- Uniforma DPPSH.docx**
- Annex no.6 – amended- Accessories.pdf
- NOTIFICATION.docx
- Annex No.7 Shoes.pdf
- Annex no.7 – amended- Shoes.pdf
- Annex no.4 - amended- T-shirts Polos and Sweaters.pdf
- Aneksi nr.7 – i ndryshuar - Këpucë.pdf **BËHET** në procedurën e rihapur, datë 5.11.2019.
- Annex No 1 Suits.pdf
- DT- UNIFORMA DPPSH - 4 VJET sistem.docx **ISHTE** në procedurën datë 19.08.2019, pezulluar.
- Annex no.9 – amended- Electronic Distribution system.docx
- Aneksi Nr.2 Kemisha.pdf **ISHTE** në procedurën datë 19.08.2019, pezulluar.
- Appendix no. 1.docx
- Shtojca nr.1.docx**
- njoftim date 24.12.2019.docx**
- Annex No.4 Tshirts Polo and Sweaters.pdf
- Sqarime nr.1.docx**
- Aneksi nr.6 – i ndryshuar - Aksesorë.pdf **BËHET** në procedurën e rihapur, datë 5.11.2019.

Sa më sipër provohet fakti, se ka ndodhur ndryshimi i DT (Dokumentave të Tenderit) dhe specifikimeve teknike të uniformave, këpucëve etj, të Policisë së Shtetit, shkak – pasojë e vjedhjes 500,000,000 lekë. Të realizuar përmes shpërdorimit të detyrës e korrupsionit nga zyrtarët e Lartë të Ministrisë së Brendshme.

Ndryshimi i specifikimet teknike dhe të dyshimta, të uniformave, këpucëve, etj, të Policisë së Shtetit gjatë procedurës së tenderimit, dhe aq më shumë të diktuar për fitues të paracaktuar, përbëjnë vepër penale.

Vlera prej 500,000,000 lekë e grabitur nga tenderi i dyshimtë i uniformave të Policisë së Shtetit të paragjykuar për fitues të paracaktuar, me skema të fshehta “mafioze”, të mirëorganizuar e të planifikuara, janë të parashikuara që në DT (Dokumentat e Tenderit).

Tenderi i uniformave të Policisë së Shtetit nuk ka nevojë për aparate audio-përgjimi, as investigim, suvejim, vëzhgim, apo përgjime të bisedave telefonike e celularësh etj.

Cdo justifikim është e papranueshme, pasi faktet zyrtare të padiskutueshme dhe provat materiale reale të grabitjes së financave të Buxhetit të Policisë së Shtetit, në vlerën prej 500.000.000 lekë janë të dokumentuara në dosjen e Tenderit të uniformave të Policisë së Shtetit, që administrojnë Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, në Ministrinë e Brendshme. Faktet dhe provat materiale i gjeni të publikuara, mjafton të klikosh: faqja në Internet www.app.gov.al, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara. Kjo është e vërteta që ka ndodhur me Tenderin e uniformave të Policisë së Shtetit, zhvilluar më datë 11.05.2020.

Tenderi i rihapur më datë 5.11.2019 për “Procedurën e Kufizuar nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër, me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat marrëveshje kuadër 4 (katër) vite. Objekti i marrëveshjes kuadër: “Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit”, me fond limit 2.800.347.570 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 11.05.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, në Ministrinë e Brendshme, është në shkelje të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 82 dt.14.02.2018 “Për ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, si organ qendror blerës, për prokurimin e fondeve buxhetore, me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrit e të ministrave të linjës, për blerjen e mallrave dhe të shërbimeve, sepse sipas pikave 1.6. Blerje uniformash dhe elementesh të tjera përbërëse të tyre; dhe 1.7. Blerje këpucësh; është përcaktuar, se procedurat e prokurimit nuk duhet të hapen bashkë, por veç për Blerje uniformash dhe elementesh të tjera përbërëse të tyre; dhe veç për Blerje këpucësh.

**VENDIM
Nr. 82 dt.14.12.2018**

PËR

NGARKIMIN E AGJENCISË SË BLERJEVE TË PËRQENDRUARA PËR KRYERJEN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, PËR DISA MALLRA DHE SHËRBIME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 11, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të pikës 1, të nenit 2, të tekstit “Rregullat e prokurimit publik”, bashkëlidhur vendimit nr.914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, **me propozimin e ministrit të Brendshëm**, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, si organ qendror blerës, për prokurimin e fondeve buxhetore, me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, ministrive, institucioneve në varësi të Kryeministrit e të ministrave të linjës, për blerjen e mallrave dhe të shërbimeve, si më poshtë vijon:

- 1.1. Blerje automjete;
- 1.2. Blerje karburanti, përveç vajgurit Jet A1;

- 1.3. Blerje materialesh kancelarie;
- 1.4. Blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim zyrash;
- 1.5. Blerje materialesh të ndryshme për pastrim;
- 1.6. Blerje uniformash dhe elementesh të tjera përbërëse të tyre;**
- 1.7. Blerje këpucësh;**
- 1.8. Blerje pjesësh këmbimi për automjete, për shërbimet profilaktike;, etj, etj.....

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara dhe institucionet e përmendura në pikën 1.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI
EDI RAMA

Në vitin 2019, për të njëjtën Lloji i procedurës së prokurimit (Objekti i marrëveshjes kuadër), me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara, në Ministrinë e Brendshme, ka hapur procedurën **vec për Blerje uniformash** dhe elementesh të tjera përbërëse të tyre; dhe **vec për Blerje këpucësh**, duke shpallur fituesit të njëjtët kompani: **Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: ”D&E SHPK” dhe “SUMMER CONF. s.r.l.”** dhe **Genç Taahhüt Giyim Tekstil İnşaat San. Ve Tic. Ltd.**, pjesmarrës në Tenderin e rihapur më datë 5.11.2019 për “Procedurën e Kufizuar nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër, me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat marrëveshje kuadër 4 (katër) vite. **Objekti i marrëveshjes kuadër: “Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit”, me fond limit 2.800.347.570 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 11.05.2020, si më poshtë:**

1. **Korrik! Në datë 25.06.2019, është shpallur fitues** nga Autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara, në Ministrinë e Brendshme. **Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: ”D&E SHPK” dhe “SUMMER CONF. s.r.l.”** (Buletini Nr.26 datë **01 Korrik 2019**-Agjencia e Prokurimit Publik).

Objekti i marrëveshjes kuadër: “Blerje uniforma për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve”, Fondi limit: 88,776,700 lekë pa TVSH.

2. **Në muajin Dhjetor 2019, është shpallur fitues** nga Autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara, në Ministrinë e Brendshme, **firma Turke Genç Taahhüt Giyim Tekstil Ltd.???** (Buletini Nr.51 datë 23 Dhjetor 2019-Agjencia e Prokurimit Publik). **Me adresë: Qendra Tregtare Gjeneral Ali Riza Cürcan Ave. Merter Nr.2/21, Stamboll Turqi, Nr.NIPT – 393058225.**

Objekti i marrëveshjes kuadër: “Blerje këpucë për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve” Fondi limit: **27,807,583 lekë** pa TVSH.

Koicidencë? Korrik për Korrik.! Në datën 14.07.2020 Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: ”D&E SHPK” dhe “SUMMER CONF. s.r.l.” +....., është shpallur fitues nga Autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara, në Ministrinë e Brendshme.

Objekti i marrëveshjes kuadër: “Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit”, me fond limit **2.800.347.570 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 11.05.2020, por jo vec uniformat dhe jo vec këpucët.**

Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: ”D&E SHPK” dhe “SUMMER CONF. s.r.l.” +....., që është shpallur fitues, është publikuar dhe në **Buletini Nr.43 datë 20 Korrik 2020**-Agjencia e Prokurimit Publik. Ajo që bie në sy, ndryshe nga shumë publikime të mëparshme, në këtë buletin si kryefjalë është pasqyruar vetëm **AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA.** Mungojnë pasqyrimet e fjalëve: **MINISTRIA E BRENDSHME, FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR, [Data: 14.07.2020]???**

Mirpo në Tenderin e rihapur më datë 5.11.2019 për “Procedurën e Kufizuar nëpërmjet Marrëveshjes Kuadër, me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat marrëveshje kuadër 4 (katër) vite. Objekti i marrëveshjes kuadër: “Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit”, me fond limit 2.800.347.570 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 11.05.2020, firma Turke, po me të njëjtin Nr.NIPT

- 393058225, por që paraqitet me emërtimin ndryshe: Genç Taahhüt Giyim Tekstil İnşaat San. Ve Tic. Ltd. Sti???, dhe me adresë ndryshe: Refahiye Mah. 281. Sk. No: 9/2 Selim Apt. Haliliye / Sanliurfa, Turkye???

Në datën 14.07.2020 firma Turke Genç Taahhüt Giyim Tekstil İnşaat San. Ve Tic. Ltd. Sti, Numri i NIPT-it 393058225, s'kualifikohet nga Autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara, në Ministrinë e Brendshme.

Sipas Njoftimit të fituesit datën 14.07.2020, firma Turke Genç Taahhüt Giyim Tekstil İnşaat San. Ve Tic. Ltd. Sti, për pretendimet e saja të s'kualifikimit, ka bërë ankesë formale, pranë Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara, në Ministrinë e Brendshme. Dhe ka marrë përgjigje negative me vendim i KSHA-së me nr.1174/2 datë 29.06.2020 (Komisioni Shqyrtimit të Ankesave)

Mirpo mbas kësaj përgjigjeje, për vazhdimin e ankesës ka dhe një KPK (Komisioni i Prokurimeve Publike), por me sa duket firma Turke Genç Taahhüt Giyim Tekstil İnşaat San. Ve Tic. Ltd. Sti, nuk është orientuar të bëjë ankesë pranë këtij Komisioni???

Hapja e ofertave ekonomike është në datën 11.05.2020, ndërsa Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 17.06.2020???, duke shkelur ligjin e prokurimeve, i cili thotë: Klasifikimi duhet të bëhet pas 10 ditëve të hapjes së ofertave ekonomike.???

Gjithsesi firma Turke me të njëjtën Numri i NIPT-it 393058225, rezulton me dy emertime të firmës dhe me dy adresa?

Kjo të lë të dyshosh se, firma Turke Genç Taahhüt Giyim Tekstil İnşaat San. Ve Tic. Ltd. Sti, në procedurën e Tenderin e rihapur më datë 5.11.2019, zhvilluar në datën 11.05.2020, dhe që është ofruar me 500,000,000 lekë më pak nga vlera e ofruar nga firma "D&E SHPK", ose (është ulur me 500,000,000 lekë, aq sa është parashikuar vjedhja që në DT (dokumentat e Tenderit), si bashkë punëtor, ka ardhur në mbështetje të firmës fituese Bashkimi i Operatorëve Ekonomik: "D&E SHPK" dhe "SUMMER CONF. s.r.l", e cila ka ofruar 500,000,000 lekë, më shumë nga vlera e ofruar nga firma Turke dhe është shpallur fitues???

Siç është evidentuar, në procedurën e tenderit të rihapur datë 5.11.2019, kemi të bëjmë me shkelja të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 82 dt.14.02.2018 për mos realizimin e procedurës veç për Blerje uniformash dhe elementesh të tjera përbërëse të tyre; dhe veç për Blerje këpucësh. Veçse është përgjegjësi e Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara, në Ministrinë e Brendshme,por dhe përgjegjësi e Agjencisë së Prokurimit Publik, që ka pranuar e publikuar këtë shkelje.

Agjencia e Prokurimit Publik mban përgjegjësi dhe për veprimet në mos përputhje për të njëjtën Lloji i procedurës së prokurimit (Objekti i marrëveshjes kuadër), nga Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara(ABP), që publikon dy qendrimet e (ABP) për vlerësimin e Ofertave Ekonomike të uniformave të Policisë së Shtetit dhe të Gardës së Republikës.

Agjencia e Prokurimit Publik mban përgjegjësi, dhe për publikimin e skemave "Mafioze" të përdorur nga zyrtarët e lartë të Ministrisë së Brendshme, në kamuflimin e tabelave të sasive të pritshme të artikujve të uniformës, të cilat kanë çuar dhe në kamuflimin e Fondin limit: 2,800,347,570 lekë pa TVSH, që është rihapur procedura e tenderimit datë 5.11.2019. Me pasojat e vjedhjes 500,000,000 lekë e të dyshimit se mund të shkojë dhe në 1,157,815,852 lekë, nga tenderi "Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit", me fond limit 2.800.347.570 lekë.

Procedura "fiktive" e tenderit "Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit", me fond limit 2.800.347.570 lekë, me pasojat e vjedhjes 500,000,000 lekë e të dyshimit se mund të shkojë dhe në 1,157,815,852 lekë i bërë si me dorë, u realizuar ashtu siç e desh ministri Lleshi. Ministri Lleshi vjen nga radhët e Forcave të Armatosura (ushtrisë shqiptare), me gradë "Gjenerali" dhe kapelja që ka mbajtur në kokë, Ministria e Mbrojtjes është furnizur asaj kohe nga "D&E SHPK" dhe e di mirë ministri Lleshi, se një kapele ka kushtuar 350 Euro/copa? Dyshohet se dhe "D&E SHPK", furnitori kryesor i Ministrisë së Mbrojtjes me uniforma ushtarake, e ka ofruar ministri Lleshi, në tenderit "Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit", me fond limit 2.800.347.570 lekë.

”**D&E SHPK**”, në vitin 2017 ka qenë pjesmarrës në tenderin me objekt Loti I “Uniforma konfeksione” me fond limit **955,804,563 lekë** pa tvsh, **procedurë e zhvilluar në datën 26.05.2017** nga autoriteti kontraktor, Ministria e Punëve të Brendshme. Drejtoria e Policisë së Shtetit.

”**D&E SHPK**” në këtë procedurë ka përdorur dokumentacionin e firmave “**Alfredo Grassi**” spa & “**EN&AD**” & “Grasi Albania” shpk.

”**D&E SHPK**” për mos plotesim të kërkesave të specifikimit teknike, ankimohet në KPP, për shfuqizimin e vendimit KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “**D&E**” & “**Alfredo Grassi**” spa & “**EN&AD**” & “Grasi Albania” shpk, **KPP:**

Vendos

1. **Të anulojë procedurën e prokurimit** “Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-66509-02-02-2017, me objekt Loti I “Uniforma konfeksione” me fond limit 955,804,563 lekë pa tvsh, procedurë e zhvilluar në datën 26.05.2017 nga autoriteti kontraktor, Ministria e Punëve të Brendshme.
2. **Autoriteti kontraktor**, me rishpalljen e procedurës së prokurimit, **të zhvillojë procedurën në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.**

Firma “**EN&AD**” e përdorur në këtë procedurë nga ”**D&E SHPK**”, rezulton të jetë pjesmarrëse në tenderin më objekt: “**Blerje këpucë**” për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve” Fondi limit: **27,807,583 lekë** pa TVSH

Në muajin Dhjetor 2019, është shpallur fitues nga Autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara, në Ministrinë e Brendshme, firma Turke Genç Taahhüt Giyim Tekstil Ltd. (Buletini Nr.51 datë 23 Dhjetor 2019-Agjencia e Prokurimit Publik).

Kështu qarkullon e përdoret dokumentacioni nga “mafia” e uniformave në veprim nëpër tendera. Kjo tregon dhe bashkëpunimin midis firmës ”**D&E SHPK**, që shpall futues “Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit”, me fond limit 2.800.347.570 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 11.05.2020, dhe firmës Turke **Genç Taahhüt Giyim Tekstil İnşaat San. Ve Tic. Ltd. Sti.**, pavërsisht se është s’kualifikuar???

Por një gjë është e sigurtë, se nga tenderi “Blerje dhe shpërndarje e uniformave dhe këpucëve të Policisë së Shtetit”, me fond limit 2.800.347.570 lekë, zhvilluar më datë 11.05. 2020, të tre firmat pjesmarrëse: ”**D&E SHPK**”, ”**KAP-KO d.o.o**” dhe **Taahhüt Giyim Tekstil İnşaat San. Ve Tic. Ltd. Sti.**, janë të “**kënaqura**, me një emërues të përbashkët:

Si i kualifikuari i këtij tenderi firma shqiptare ”**D&E SHPK**”, ashtu dhe **të s’kualifikuarit** firma Turke **Genç Taahhüt Giyim Tekstil İnşaat San. Ve Tic. Ltd. Sti.** dhe firma Kroate ”**KAP -KO d.o.o**”, të cilat kanë qenë në mbikqyerjen e ”rreptë” e të orientuar për këtë tender ”fiktiv” nga zyrtarët e lartë të Ministrisë së Brendshme (Ministri Sandër Lleshaj e Sekretari i Përgjithshëm Plarent Ndreca), gjatë gjithë procedurës, do ti realizojnë të organizuar bashkë uniformat e këpucët Policisë së Shtetit. Duke e ndarë produktin: **uniformat** dhe pjesët përbërëse të saj, do ta realizojnë në bashkëpunim ”**D&E SHPK**” me ”**KAP-KO d.o.o**”, ndërsa e gjithë **sasia e këpucëve** do të realizohet nga **Giyim Tekstil İnşaat San. Ve Tic. Ltd. Sti.**

2. MINISTRIA E MBROJTJES

Firma “D&E” SHPK, si fituese tenderave të uniformave ushtarake në Ministrinë e Mbrojtjes që nga viti 2012 e deri më sot (2020), po të krahasosh bilancet e blerjeve me shitjet, janë në raport të zhdrejtë. Blerjet kapin vlerën 30%, ndërsa shitjet janë 70% më shumë.

Por këtë e ka lindur nevoja që të krijojnë disa grupe “mafioze” që mashtrojnë me licencë si persona të tillë si Petrit Kasapi, oraganizatori dhe “koka” e grupit, i cili ka patur në biznesin e tij: Bar kafe- Restorant me emrin “Bluri”, në Lundër të Tiranës dhe në përbërje të grupit firma “**D&E**” SHPK me pronar të vetëm **Ismail Kadiu**, dhe “**MARSI&AL**” SHPK me bashkë ortakët **Misar Tufi dhe Petrit Kasapi.**

Këto grupe të cilat shiten si kompani prodhuese veshje, por nuk janë asgjë tjetër, veçse grupe “mafioze” 4 deri në 5 vetë, të cilët menazhojnë marrëdhëniet midis zyrtarë të lartë të shtetit dhe shpërndarjen e vjedhjeve të buxhetit të shtetit, që shkojnë në xhepat e tyre dhe të zyrtarëve që i mbështesin.

Mënyra se si veprojnë, importon mallra njëri nga pjestarët e grupit dhe i qarkullojnë nga njëri tek tjetri, për të justifikuar të ardhurat e “majme”, që krijohen nga këto vjedhje.

Të tre këto grupe vetë ofertojnë, vetë japin çmimet dhe fitojnë të Procedurat me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës.

Kjo tregon se të gjitha kontratat me Ministrinë e Mbrojtjes nga “D&E” SHPK dhe “MARS&AL” SHPK, diferecat e çmimit midis fituesit ka qenë jo më shumë se 200,000 lekë për çdo procedurë tenderimi që nga viti 2012, kap vlerën 85 miliard dollarë, rezultojnë se këta fitues njëherë “D&E” SHPK dhe njëherë “MARS&AL” SHPK, nuk janë as 100,000 dollarë.

Qarkullimi i tyre ndërmjet firmave “D&E” SHPK dhe “MARS&AL” SHPK, nën drejtimin e “kokës” së grupit kriminal, Petrit Kasapi, duke mos mjaftuar me kaq, por për të vjedhur akoma më shumë, në bashkëpunim me firmën “RISA”-2013, me seli në qytetin e Librazhdit, e cila u dënua nga organet e drejtësisë si firmë “mashtroese”, në vlerën 20 milion dollarë. Përfaqësuesi i firmës “RISA”-2013, vuan dënimin e burgut, ndërsa grupet kriminale, gëzojnë paratë e taksa paguesëve shqiptar.

“D&E” SHPK dhe “MARS&AL” SHPK, nuk kanë probleme me organet tatimore e doganore, sepse “sillen” mirë, nuk paguajnë detyrimet, kanë në pëdorim nga dy tre vula të ndryshme dhe kur nënshkruajnë fatura përdorin nga 2-3 firma të ndryshme,(këto janë më se e verifikueshme).

Nga Ministria e Mbrojtjes nga këto dy firma, Është përfituar: gjithsej 8,371,396,894 lekë.

Gazeta TemA, e botuesit Mero Baze, më datën 29 Mars 2014 do të botonte shkrimin: LETRA/ Ushtria nën mëshirën e pazareve të Imamit (Arben Imami ish Ministri i Mbrojtjes). Një grup oficersh prane Brigades Logjistike, si specialist te llogjistikës, informojë per nje problem shume shqetesues per Forcat e Armatosura. Shqetesimi ka te beje me uniformat ushtarake te kontraktuara nga dy firma kontraktore kane qene mbizoteruese per furnizimin e FA me mallra dhe sherbime. Keto firma jane D&E shpk dhe Marsi&AL shpk keto kane fituar pothuajse te gjitha procedurat e tenderimit, sic jane tenderi skrapit, i municioneve, i veshmbathjes, dhe shitjeve te objekteve ushtarake gjithashtu keto firma kane fituar tenderin e aparatit te pergjimit.

Po ju bejme me dije se personi qe drejton firmen eshte ortak i drejperdrejte i Z. Arben Imami sepse ka folur dhe bere presion gjithmone ne emer te ministrit. Duke emeruar Gjenerale dhe officer madhore neper detyra gjithashtu duke hequr dhe hedhur ne mes te rruges oficeret qe kundershtonin.

Gjithashtu, Oficeret e Brigades Logjistike në këtë letër bëjnë me dije, se Tenderin e parë për blerjen e uniformave të ushtrisë zhvilluar ne 2012, ju dhurua Firmës D&E (firma e ministrit) me vlere 1.894.490.280 leke duke shkelur te gjitha rregullat e tenderimit.

Duke qene se pushteti ra dhe te marim cfare te marim ministri ne ikje mendoi te lidhi dhe nji kontrate tjeter pa tender dhe pa konkurrence me firmen e vet Marsi&AL me nji vlere 1.248.441.600 leke te reja per 4 vjet cdo vite

nga te ardhurat me objekt Blerje kostume kamuflazhi, duke shkelur me te dyja kembet per here te pare ne historine e tenderimit duke dhene nje tender pa shpallje pa konkurrence me nje vlere kaq te madhe.

Duke ja dhene nje firme te sapo krijuar MARSIAL qe nuk ka pasur asnjehere kontrata te tilla, por kjo firme Lindi ne momentin qe erdhi Arben Imami ne Ministrine e Mbrojtjes. **Tenderin e Pare e fitoi "D&E" kurse te dytin e lidhi me "Marsi&AL"**.

Por, perkundrazi ish Ministrja e re Mimi Kodheli, dhe me pas Ministrja aktuale Olta Xhaçka, qetesisht vazhdoje akoma punen me dy kontraktorët, **D&E shpk dhe Marsi&AL shpk**, konkretisht duke dhene ketyre dy firmave "fantazma" **5,025,144,946 lekë qe nga viti 2014**, sipas llojet dhe pergjedhja e procedurës, llojet e procedurave te prokurimit, **Procedurë me negociim, pa shpallje paraprake te njoftimit te kontratës**, si me poshte:

Sipas vlerave te transakcioneve nga Dega e Thesarit Tiranë D&E shpk, ka perfituar **3,266,220,195 lekë** me TVSH, "uniforma dhe veshje te tjera speciale" dhe "shpenzime per rritjen e AQT dhe pajisje te tjera teknike". Eshhte per tu theksuar se, nga vlere prej **3,266,220,195 lekë** me TVSH, duhet zbritur vlere **106,523,952 lekë** me TVSH, sepse eshte perfshire blerjet e **uniformave per punonjesis e policises se Drejtorises se Pergjithshme te Burgjeve** (kontrate nr.6158/4 date 26.08.2019), te lidhur me Bashkimin e Operatorëve Ekonomike (BOE) **D&E shpk dhe "Summer Conf srl"**.

Sipas Buletinit Nr.15 date 15 Prill 2019 te Agjencise se Prokurimit Publik, faqet 23/304 dhe 24/304, procedura "Blerje uniforma pe Drejtorine e Pergjithshme te Burgjeve", **ne Fondit limit: 88,776,700 lekë** pa TVSH, si afati kohor per dorëzimin, ashtu dhe perhapjen e ofertave ose kerkesave per pjesmarrije, ka qene Data 02.05.2019, ora 10.00, Vendi Ministria e Brendshme, Agjencia e Blerjeve te Pergjithshme te Pergjithshme.

Ndërsa, **Sipas Buletinit Nr.26 date 01 Korrik 2019 te Agjencise se Prokurimit Publik**, faqet 283/632 dhe 284/632, per proceduren "Blerje uniforma pe Drejtorine e Pergjithshme te Burgjeve", **ne Fondit limit: 88,776,700 lekë** pa TVSH, **Ministria e Brendshme, Agjencia e Blerjeve te Pergjithshme te Pergjithshme**, Formulari i Njoftimit te Operatorëve Ekonomike te Suksesshme ne Marrëveshjen Kuader (Data 25.06.2019), **shpall fitues BOE "D&E" SHPK + SUMMER CONF SRL" ne vleren 106,523,952 lekë me TVSH**.

Kështu, nga Ministria e Mbrojtjes, vlere e perfituar nga **D&E shpk**, "uniforma dhe veshje te tjera speciale" dhe "shpenzime per rritjen e AQT dhe pajisje te tjera teknike", **qe nga viti 2014**, **eshte 3,163,696,243 lekë** me TVSH. (3,266,220,195 lekë - 106,523,952 lekë = **3,163,696,243 lekë** me TVSH).

Sipas vlerave te transakcioneve nga Dega e Thesarit Tiranë Marsi&AL shpk, **qe nga viti 2015**, ka perfituar **1,861,448,703 lekë** me TVSH, "uniforma dhe veshje te tjera speciale".

Kontraktori D&E shpk, perfaqesohet nga **Ismail Kadiu**, ndërsa **Kontraktori Marsi&AL shpk**, perfaqesohet nga **Misar Tufi**.

Ismail Kadiu me Misar Tufin jane bashkepunetor, ne procedurat e tenderimit mbeshtesin njeri-tjetrin, japin oferta ekonomike per njeri tjetrin. Ndërsa **Ministria e Mbrojtjes** sipas oreksit, shpall fitues njehere njerin, nje here tjetrin, te dy kanë dokumentacionin perkates:

Ismail Kadiu perdor dokumentacionin e firmes Italiane **Alfredo Grassi SPA** te firmes Rumune **"Summer Conf srl"**, te firmes Turke **"Yakupoglu Tekstil ve deri san. Tic. As. a. Vedat Yakupoglu"**

Ndërsa **Misar Tufi** perdor dokumentacionin e firmave Turke **"Yakupoglu Tekstil ve deri san. Tic. As. a. Vedat Yakupoglu"**.

Madje, sipas **QKB** (Qendra Kombetare e Bisnesit), Ekstrakt historik i regjistrimit tregtar per te dhënat e subjektit SH.P.K., Gjendja e Regjistrimit, **rezulton se, D&E shpk dhe Marsi&AL shpk**, te kene te njëtin nr.telefoni **0682008631**, ndërsa secili prej tyre perkatesisht **nga Gjendja e Rregjistrimit disa nga te dhënat i kanë, si me poshte:**

Administratori Ismail Kadiu i subjektit **"D&E" shpk**, Numri unik i identifikimit te subjektit(NUIS), K71804001C, Data e Regjistrimit dhe Data e themelimit 24/05/2007, Objekti e aktivitetit: **1.Imp-exp** artikuj ndryshem industriale.

2. **Gërmime**, ndërtime ndryshme, impiant teknologjike, etj, Import Eksport, Gjeneral kontraktor në sektorin e ndërtimeve, të tregtisë dhe të shërbimeve **të prodhimit për artikuj veshje pune, ushtarake**, impiante teknologjike, elektrike, kondicionimi, aspirimi dhe hidraulike. **Prodhome aplikacione software dhe sistemesh për menaxhimin e shpërndarjes së uniformave dhe mallrave**. Tregtim, armë, municione dhe pajisje të ndryshme ushtarake. **Ortakët Ismail Kadiu**.

Administratori Ismail Kadiu i subjektit **“D&E shpk”**, nga Gjendja e Rregjistrimit **mashton** me të dhënë: **të prodhimit për artikuj veshje pune, ushtarake**???

“D&E” shpk, edhe pse miliarda lekë që ka përfituar nga buxheti Ministrisë së Mbrojtjes, **nuk dispon** të ketë në pronësi ambjente për rrobaqepsi, makineri e pajisje (nuk ka listë të tyre të deklaruara në organet tatimore), **të prodhimit për artikuj veshje pune, ushtarake**, nuk ka të siguruar punëtor (nuk ka listë të tyre të deklaruara e të derdhura në organet e sigurimeve shoqërore, që merren me prodhimin e këtyre veshjeve).

Administratori Misar Tufi i subjektit **“Marsi&AL” shpk**, Numri unik i identifikimit të subjektit(NUIS), L21502014C, Data e Regjistrimit dhe Data e themelimit 02/03/2012, Objekti e aktivitetit: Import-eksport, tregtim me shumicë e pakicë i artikujve të ndryshëm industrial, ushqimor, konfeksione, veshje, këpucë, material sportive, pjesë këmbimi për automjete, mobileri etj. **Prodhimin me materialet e veta dhe/ose porosities, përpunimin e të gjitha llojeve të konfeksioneve të veshjeve**. Tregti armë, municione dhe pajisje të ndryshme ushtarake. **Ortakët Petrit Kasapi**.

Administratori Misar Tufi i subjektit **“Marsi&AL” sh.p.k** nga Gjendja e Rregjistrimit **mashton** me të dhënë: **Prodhimin me materialet e veta dhe/ose porosities, përpunimin e të gjitha llojeve të konfeksioneve të veshjeve**???

“Marsi&AL” sh.p.k, edhe pse miliarda lekë që ka përfituar nga buxheti Ministrisë së Mbrojtjes, **nuk dispon** të ketë në pronësi ambjente për rrobaqepsi, makineri e pajisje, (nuk ka listë të tyre të deklaruara në organet tatimore), **për prodhimin me materialet e veta dhe/ose porosities, përpunimin e të gjitha llojeve të konfeksioneve të veshjeve**???, nuk ka të siguruar punëtor (nuk ka listë të tyre të deklaruara e të derdhura në organet e sigurimeve shoqërore, që merren me prodhimin e këtyre veshjeve).

Sipas Buletinit Nr.41 datë 14 Tetor 2019 të Agjencisë së Prokurimit Publik, faqet 23/304 dhe 24/304, **Ministria e Mbrojtjes** hap Procedurën e hapur me objekt të kontratës: “Blerje uniforma ushtarake dhe pjesët përbërëse të tyre”, **me fondin limit: 199,574,450 lekë pa TVSH**.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: kontrata **do të realizohet gjatë dy viteve buxhetore (2019 dhe 2020)**. Si afati kohor për dorëzimin e ofertave, ashtu dhe për hapjen e tyre, Data 04/11/2019, Ora 10.00, Vendi” Prokurim elektronik në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al **Për arsye të ndryshme, kjo procedurë është hapur më datë 10.11.2019**.

Sipas Buletinit Nr.48 datë 02 Dhjetor 2019 të Agjencisë së Prokurimit Publik, faqet 64/235, 65/235 dhe 66/235, **Ministria e Mbrojtjes**, Formulari i Njoftimit të Fituesit;

Për: Bashkimin e operatorëve ekonomikë:

- **“D&E” sh.p.k., me NUIS K71804001C dhe**
- **“Summer Conf srl” sh.p.k., NUIS 8145996, se:**

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë bashkimin e operatorëve ekonomikë **“D&E” sh.p.k.**, me NUIS K71804001C dhe **“Summer Conf srl” sh.p.k.**, NUIS 8145996, krijuar me akt-marrveshjen noteriale nr. rep. 1764, nr. kol. 336, datë 08.11.2019, përfaqësuar nga shoqëria **“D&E” sh.p.k.** sipas prokurës së posaçme nr. rep. 1712, kol. 326, datë 31.10.2019, adresë Rruga “Milto Tutulani”, pallati “Alb Millenium”, nr. 6, kati II, Tiranë, **se oferta e paraqitur, me vlerë të përgjithshme prej 199,333,400 lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme për procedurën me objekt “Blerje uniforma ushtarake dhe pjesët përbërëse të tyre”**.

Procedura për “Blerje uniforma ushtarake dhe pjesët përbërëse të tyre”, **hapet me fondin limit 199,574,450 lekë pa TVSH**, ndërsa **Ministria e Mbrojtjes, shpall fitues bashkimin e operatorëve ekonomikë “D&E” sh.p.k.** dhe

“**Summer Conf srl**” sh.p.k me vlerën **199,333,400 lekë pa TVSH**, (203,320,068 lekë me TVSH), sepse oferta e paraqitur prej tyre, rezulton **si oferta e suksesshme** nga kjo procedurë.

Por nga krahasimi i fondit limit prej **199,574,450 lekë pa TVSH** që është hapur procedura, me vlerën **199,333,400 lekë pa TVSH** që është shpallur fituesi, rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomikë “D&E” sh.p.k. dhe “Summer Conf srl” sh.p.k, **të jenë ulur më pak nga fondi limit me një diferencë prej 241,050 lekë pa TVSH** (199,574,450 lekë minus 199,333,400 lekë baraz 241,050 lekë), ose janë ulur më pak 0,9998 %, pra nuk arrin të ulen as dhe 1% më pak nga fondi limit.

Interesant fakti! Bashkimi i operatorëve ekonomikë “**D&E**” sh.p.k., dhe “**Summer Conf srl**” sh.p.k., janë krijuar me akt-marrveshjen noteriale **datë 08.11.2019**, ndërsa prokura e posaçme mban **datë 31.10.2019???**

Sipas Buletinit Nr.48 datë 02 Dhjetor 2019 të Agjencisë së Prokurimit Publik, faqet 64/235, 65/235 dhe 66/235 (bashkëlidhur këtij materiali), në procedurën e hapur më datë 10.11.2019, me objekt me objekt “Blerje uniforma ushtarake dhe pjesët përbërëse të tyre” me fondin limit 199,574,450 lekë pa TVSH, **rezulton se ka qenë pjesmarrës dhe është kualifikuar** Bashkimi i operatorëve ekonomikë “**Marsi&Al**” sh.p.k., me NUIS L2502014K dhe “**Yakupoglu Tekstil ve deri san. Tic. As. a. Vedat Yakupoglu**”, krijuar me akt-marrveshjen noteriale nr. rep. 1612, nr. kol. 446, datë 01.11.2019, përfaqësuar nga shoqëria “Marsi & Al sh.p.k., sipas prokurës së posaçme nr. rep. 1712, kol. 326, datë 01.11.2019, **dhe ofertë në vlerën 199,456,600 lekë pa TVSH**.

Por nga krahasimi i fondit limit prej **199,574,450 lekë pa TVSH** që është hapur procedura, me vlerën **199,456,600 lekë pa TVSH** që është kualifikuar, Bashkimi i operatorëve ekonomikë “**Marsi&Al**” sh.p.k., me NUIS L2502014K dhe “**Yakupoglu Tekstil ve deri san. Tic. As. a. Vedat Yakupoglu**”, rezulton të **jenë ulur më pak nga fondi limit me një diferencë prej 117,850 lekë pa TVSH** (199,574,450 lekë - 199,456,600 lekë = 117,850 lekë), ose janë ulur më pak 0,9994 %, pra dhe ky Bashkimi i operatorëve nuk arrinë të ulen as dhe 1% më pak nga fondi limit, ose “**D&E**” sh.p.k., është ulur më shumë se “**Marsi&Al**” sh.p.k., **123,200 lekë**, (241,050 lekë = 117,850 lekë = 123,200 lekë).

Si përfundim:

Firmat “D&E” sh.p.k., dhe “Marsi&Al” sh.p.k., kanë përfituar gjithsej nga buxheti e Ministrisë Mbrojtjes, 8,371,396,894 lekë me TVSH, përkatësisht secila:

“**D&E**” sh.p.k., **5,261,506,591 lekë me TVSH** (1,894,490,280 lekë + 3,163,696,243 lekë + 203,320,068 lekë = **5,261,506,591 lekë me TVSH**).

“**Marsi&Al**” sh.p.k., **3,109,890,303 lekë me TVSH** (1,148,441,600 + 1,861,448,703 = **3,109,890,303 lekë me TVSH**).

Në një nga gazetat në fillim të këtij viti (2020), kishte botuar shkrimin: **Kush e kryeson listën e kontraktorëve më të mëdhenj të shtetit më 2019. Me të dhëna të shpenzimeve të Thesarit të Shtetit**, pasqyronte kompanitë më të mëdha të kontraktuara nga shteti për projekte investimesh publike, si dhe projektet për të cilat këto kompani kanë marrë pagesat. **Kompania D&E me pronar të vetëm Ismail Kadiu** është furnitori kryesor i ushtrisë shqiptare me materiale ushtarake **D&E është përfituesi i gjashtë më i madh i fondeve publike për vitin e kaluar**.

Nga sa më sipër, rezulton e provuar të jenë ezauruar të gjithë elementët e veprave penale të sipërcituara.

Të ndodhur përpara këtyre rrethanave kërkojmë nga **Prokuroria e Posaçme kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit-SPAK**, “Regjistrimin dhe fillimin e procedimit penal ndaj personave të kallëzuar, të identifikuar ose jo si dhe kryerjen e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme për sqarimin e plotë të çështjes”.

KALLËZUES

Përfaqësuesit e Grupit Parlamentar “Demokrat”

Deputet

